



PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT I KOMUNËS SË PRISHTINËS 2018-2022

Prishtinë, korrik 2017

Komuna e Prishtinës

Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Prishtinës 2018-2022

Ky dokument u miratua nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më datë 09 tetor 2017.



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Ky dokument është hartuar me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”, që menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Akademinë për Trajnime dhe Asistencë Teknike (ATTA) dhe organizata tjera të shoqërisë civile në Kosovë. Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë rrethanë nuk i atribuohet donatorit.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhja ekzekutive	5
1. Hyrje	6
2. Metodologjia	7
3. Analiza e gjendjes	9
3.1. Të dhëna të përgjithshme për arsimin në Prishtinë	9
3.2. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë	11
3.3. Zbatimi i kurrikulës së re	13
3.4. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore	14
3.5. Përfshirja në edukimin parashkollor	15
3.6. Mjedis i sigurt dhe miqësor në shkollë	16
4. Strategjitë për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës	18
5. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë	19
6. Zbatimi i kurrikulës së re	25
7. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore	27
8. Përfshirja në edukimin parashkollor	31
9. Mjedis i sigurt dhe miqësor në shkollë	33
10. Analiza e rrezikut	36
11. Buxheti	41
12. Strategjia e komunikimit	43
Shtojca 1: Korniza për vlerësimin e performancës	44
Shtojca 2: Plani i zbatimit dhe buxheti	44
Shtojca 3: Pjesëmarrësit e procesit të planifikimit	78

Lista e shkurtesave

BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FNV	Fëmijët me Nevoja të Veçanta
GiZ	Bashkëpunimi Zhvillimor Gjerman
IEAA	Institucionet edukative-arsimore dhe aftësuese
IP	Institucioni parashkollor
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KKK	Korniza e Kurrikulit të Kosovës
LLL	Mësimi gjatë gjithë jetës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OS	Objektiv Strategjik
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
PZHA	Plani Zhvillimor i Arsimit
PZHSH	Plan Zhvillimor i Shkollës
QNP	Qendrat për Ngritje Profesionale
RPV	Rishikimi i Përbashkët Vjetor
SHFMU	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët
SHML	Shkolla e mesme e lartë
PK	Policia e Kosovës
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
SWOT	Sukseset, Dobësitë, Mundësitë, Rreziqet
SZHMFH	Standardet e Zhvillimit të Mësimin në Fëmijërinë e Hershme
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
ZhPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Përmbledhje ekzekutive

Arsimi në komunën e Prishtinës është sektori më i rëndësishëm i kësaj komune, si për nga vëllimi i punëve dhe pjesëmarrja në buxhetin komunal, por edhe për nga implikimet e mëdha që mund të ketë për shoqërinë. DKA e komunës së Prishtinës menaxhon rreth 70 institucione edukativo arsimore dhe aftësuese (IEAA), përmes të cilave ofron shërbime për rreth 45 mijë fëmijë e nxënës. DKA ka mbi 3 mijë të punësuar dhe shpenzon afër 40% të buxhetit komunal të komunës së Prishtinës.

Në përgjithësi vlerësohet se cilësia e arsimit në komunën e Prishtinës ka shënuar progres viteve të fundit dhe është në nivel më të mirë krahasuar me komunat tjera të Kosovës, por pavarësisht kësaj, konsiderohet se ende ka nevojë për investime dhe për përmirësimin e gjendjes së arsimit në shumë fusha e drejtime, andaj kërkohet një përqendrim më i madh i komunës së Prishtinës në fushën e arsimit edhe në vitet vijuese.

Bazuar në këtë, komuna e Prishtinës është përzgjedhur nga Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim” (KEEN) për hartimin e “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022”. Ky plan zhvillimor është hartuar bazuar kryesisht në sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga komuna e Prishtinës, të cilët janë caktuar nga komuna, si: drejtues dhe zyrtarë të DKA-së dhe të drejtorive tjera komunale, personel udhëheqës dhe mësimdhënës të IEAA-ve, përfaqësues të nxënësve dhe përfaqësues nga shoqëria civile që merren me çështjet e arsimit, të cilët e kanë përbërë Grupin Punues për hartimin e këtij plani zhvillimor të arsimit.

Në mesin e shumë çështjeve, sfidave e problemeve me të cilat ballafaqohet arsimi në komunën e Prishtinës, Grupi Punues për hartimin e “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022” ka vendosur që në kuadër të këtij plani të përfshihen pesë fushat në vijim:

1. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë
2. Zbatimi i kurrikulës së re
3. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore
4. Përfshirja në edukimin parashkollor
5. Mjedisi i sigurt dhe miqësor në shkollë

Grupi punues ka përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe parimet mbi të cilat ndërtohet ky plan zhvillimor i arsimit. Pastaj, për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan është bërë analiza e gjendjes, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjike, janë përcaktuar rezultatet e pritshme, si dhe janë caktuar dhe përshkruar masat dhe aktivitetet e parapara, realizimi i të cilave do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit në komunën e Prishtinës. Po ashtu, janë përcaktuar edhe treguesit për secilin objektiv, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani.

Gjithashtu, është përcaktuar buxheti për këtë plan zhvillimor, nga ku del se Plani Zhvillimor i Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022, parashihet që për periudhën pesëvjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej **€28,053,445**, prej të cilave **€18,988,445** parashihen të mbulohen nga buxheti komunal i Komunës së Prishtinës, ndërsa **€9,065,000** parashihen të mbulohen nga donatorët e ndryshëm dhe/ose institucionet qendrore të Kosovës.

1. Hyrje

Komuna e Prishtinës si kryeqendër e Kosovës është komuna më e madhe në Republikën e Kosovës dhe qendra më e rëndësishme administrative e vendit. Sipas regjistrimit të popullsisë në Kosovë më 2011, komuna e Prishtinës ka 198,897 banorë¹. Por, duke qenë kryeqyteti i Kosovës, në komunën e Prishtinës janë të përqendruara pothuajse të gjitha institucionet shtetërore e publike qendrore, qendrat universitare publike e private, institucionet e ndryshme kulturore, një numër i madh i bizneseve dhe kompanive të mëdha, etj. Të gjitha këto bëjnë që në komunën e Prishtinës të jetojnë apo të zhvillojnë aktivitetet ditore edhe shumë banorë të komunave të tjera të Kosovës. Bazuar në këto mund të thuhet se zhvillimet në cilëndo fushë në Prishtinë reflektojnë në nivel vendi dhe mund të shërbejnë si model për komunat e tjera të Kosovës.

Ekzekutivi i komunës së Prishtinës, përveç pozitës së kryetarit dhe nënkryetarit, aktualisht përbëhet nga 13 drejtori komunale: Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm².

Njëra ndër drejtoritë më të mëdha dhe më të rëndësishme e komunës së Prishtinës është Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). DKA e komunës së Prishtinës në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësiave ligjore, udhëzimeve administrative të MASHT-it, statutit dhe rregulloreve të komunës së Prishtinës dhe të politikave strategjike të kryetarit të komunës në fushën e veprimtarisë së saj, është kompetente dhe ka përgjegjësinë për menaxhimin dhe koordinimin e strukturës së arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunën e Prishtinës. DKA e komunës së Prishtinës menaxhon rreth 70 institucione edukativo arsimore dhe aftësuese (IEAA), përmes të cilave ofron shërbime për rreth 45 mijë fëmijë e nxënës. DKA ka mbi 3 mijë të punësuar dhe shpenzon afër 40% të buxhetit komunal të komunës së Prishtinës.

Bazuar në këtë, Komuna e Prishtinës është përzgjedhur nga Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim” (KEEN)³ për hartimin e “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022”⁴. Për realizimin e këtij plani zhvillimor, komuna e Prishtinës dhe Projekti KEEN kanë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi, përmes së cilës palët janë pajtuar për detyrat dhe përgjegjësitë e të dy palëve gjatë procesit të hartimit të këtij plani.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2011 (<http://ask.rks-gov.net>).

² Faqja zyrtare e Komunës së Prishtinës: <https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Administrates.aspx>.

³ Projekti KEEN zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me organizatat partnere, ndërsa financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

⁴ Fillimisht është planifikuar që plani zhvillimor të përfshijë periudhën 2017 – 2021, mirëpo gjatë procesit të planifikimit dhe hartimit të planit është vlerësuar se do të jetë e vështirë ose e pamundur që kostoja financiare e këtij dokumenti të mund të përfshihet në vitin fiskal 2017, për shkak se rishikimi i buxhetit ofron mundësi të kufizuara për ndryshime të mëdha në buxhet. Prandaj, është vendosur që plani zhvillimor të përfshijë periudhën 2018 – 2022, në mënyrë që komuna të ketë kohë dhe mundësi që të planifikojë si duhet buxhetin për gjithë periudhën që përfshinë ky dokument.

2. Metodologjia

Procesi i hartimit të “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022” ka qenë një proces mjaft i gjatë dhe gjithëpërfshirës. Në përgjithësi ky plan është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga komuna e Prishtinës, të cilët janë caktuar nga vet komuna, si: udhëheqës dhe zyrtarë të DKA-së, përfaqësues të IEAA-ve, si dhe përfaqësues të grupeve të tjera të interesit që merren me fushën e arsimit në komunën e Prishtinës.

Në përputhje me detyrimet që ka marrë përsipër Projekti KEEN, ky projekt ka marrë përsipër organizimin e të gjitha punëtorive të nevojshme dhe ka angazhuar dy konsulentë për të ofruar përkrahje dhe ekspertizë gjatë gjithë procesit të hartimit të “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022”, të cilët i kanë përpunuar dhe finalizuar sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të komunës së Prishtinës, si dhe e kanë finalizuar dokumentin e këtij plani.

Procesi i hartimit të “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022” deri te aprovimi i këtij dokumenti nga Kuvendi Komunal i Komunës së Prishtinës ka kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Fazat në fjalë janë të përshkruara shkurtimisht në vijim:

Faza 1: Përgatitja

Gjatë kësaj faze përfaqësuesit e Projektit KEEN kanë vendosur kontaktet me komunën e Prishtinës dhe kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Kryetarin e komunës; komuna e Prishtinës ka caktuar personat që do të jenë pjesë e Grupit Punues për hartimin e planit; Projekti KEEN ka identifikuar dhe ka angazhuar konsulentët që do ta lehtësojnë procesin dhe do ta hartojnë planin; janë mbajtur takime koordinuese mes anëtarëve të Grupit Punues dhe konsulentëve për planifikimin e datave të mbajtjes së punëtorive.

Faza 2: Përcaktimi i fushave

Projekti KEEN më 28 mars 2017 ka organizuar një punëtori të përbashkët me grupet punuese për hartimin e planeve komunale të veprimit të komunave të ndryshme. Në këtë punëtori pjesëmarrësit janë informuar në detaje rreth procesit të hartimit të planeve lokale të veprimit dhe kanë përcaktuar fushat që do të përfshihen në kuadër të planit. Grupi Punues i komunës së Prishtinës ka diskutuar dhe është përcaktuar për fushat që do të përfshihen në këtë plan zhvillimor të arsimit.

Faza 3: Analiza e gjendjes dhe mbledhja e të dhënave

Për nevoja të analizës së gjendjes për fushat që janë përfshirë në këtë plan është organizuar një punëtori njëditore në Prishtinë, nën moderimin e konsulentëve dhe me pjesëmarrjen anëtarëve të Grupit Punues. Kjo punëtori është mbajtur më 2 maj 2017 dhe përmes analizës SWOT, bazuar në njohuritë e pjesëmarrësve, janë identifikuar sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për secilën nga fushat e përfshira në kuadër të këtij plani. Gjithashtu, gjatë kësaj faze janë mbledhur të dhëna dhe statistika zyrtare që kanë ofruar zyrtarët e DKA-së së komunës së Prishtinës për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan.

Faza 4: Përcaktimi i misionit, vizionit, objektivave dhe masave

Për nevoja të planifikimit, më 29 maj dhe më 30 qershor 2017 është mbajtur një punëtori dyditore në Prishtinë, nën moderimin e konsulentëve dhe me pjesëmarrjen anëtarëve të Grupit Punues. Gjatë kësaj punëtorie, është përcaktuar vizioni dhe misioni i këtij plani dhe për secilën fushë që është përfshirë në këtë plan, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjike, janë definuar rezultatet e pritshme, si dhe janë caktuar dhe përshkruar

masat dhe aktivitetet e parapara. Gjithashtu, gjatë kësaj punëtorie janë definuar edhe treguesit për secilin objektiv, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani.

Faza 5: Planifikimi i buxhetit dhe planit të zbatimit

Për nevoja të planifikimit të buxhetit dhe të planit të zbatimit të këtij plani zhvillimor të arsimit, më 7 korrik 2017 është mbajtur një punëtori njëditore në Prishtinë. Në këtë punëtori, nën moderimin e konsulentëve dhe me pjesëmarrjen anëtarëve të Grupit Punues është përcaktuar buxheti për të gjitha masat dhe aktivitetet e parapara për periudhën pesëvjeçare, duke e ndarë në kategori varësisht prej burimit të financimit, si dhe është detajuar plani i zbatimit të këtij plani zhvillimor të arsimit për periudhën pesëvjeçare, duke përcaktuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Faza 6: Hartimi i dokumentit të Planit Zhvillimor

Në bazë të dokumenteve të hartuara gjatë procesit, në përfundim të tij u hartua edhe drafti i Planit Zhvillimor të Arsimit, i cili, pasi u shqyrtua nga Grupi për Planifikim i DKA-së, mori formën e draftit përfundimtar.

3. Analiza e gjendjes

Grupi Punues për hartimin e “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022”, pas diskutimeve që ka pasur, ka vendosur që në kuadër të këtij plani zhvillimor të arsimit të përfshihen pesë fusha të rëndësishme të përmendura në vijim:

1. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë
2. Zbatimi i kurrikulës së re
3. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore
4. Përfshirja në edukimin parashkollor
5. Mjedis i sigurt dhe miqësor në shkollë

Për analizën e gjendjes në këto pesë fusha është përdorur Analiza SWOT, në mënyrë që të identifikohen sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për secilën nga këto fusha të përfshira në këtë plan zhvillimor të arsimit.

Përveç të dhënave që kanë dalë nga analiza SWOT, janë siguruar të dhëna dhe statistika zyrtare të nevojshme për analizën e gjendjes të nivelit komunal dhe atij qendror. Në vijim janë prezantuar analiza e gjendjes dhe disa të dhëna të përgjithshme për arsimin në komunën e Prishtinës për secilën nga pesë fushat e përfshira në këtë plan zhvillimor të arsimit.

3.1. Të dhëna të përgjithshme për arsimin në Prishtinë⁵

Bazuar në buxhetin e vitit 2017, nga totali i buxhetit të komunës së Prishtinës për këtë vit që është 62,023.630€ 39.82 % e buxhetit vjetor komunal është i dedikuar për fushën e arsimit, përkatësisht 24,700.208€ janë për fushën e arsimit, të ndara sipas kategorive të prezantuara në tabelën në vijim:

Burimi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
Grantet qeveritare	18086803	1423405	620000	-	-	20130208
Të hyrat vetanake	-	1200000	-	210000	3160000	4570000
Gjithsej	18086803	2623405	620000	210000	3160000	24700208

Komuna e Prishtinës ka gjithsej 70 institucione edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, ku vijnë procesin edukativ-arsimor gjithsej 45,438 fëmijë e nxënës. Të dhënat e hollësishme për këto institucione janë të prezantuar në tabelën në vijim.

Institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese të nivelit të arsimit parauniversitar në komunën e Prishtinës				
Institucionet sipas niveleve	Numri i institucioneve	Numri i fëmijëve/nxënësve		
		M	F	GJ
Institucione parashkollore – publike	8	854	765	1619
Institucione parashkollore – me bazë në komunitet	6	209	197	406
Institucione parashkollore – me partneritet publiko-privat	1	65	66	131
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta – publike	42	16765	16156	32921
Shkolla të mesme të larta – Gjinnaze – publike	6	2289	3070	5359
Shkolla të mesme të larta – Shkolla profesionale	7	2805	2197	5002

⁵ Të gjitha të dhënat dhe statistikat e përfshira në këtë seksion bazohen në të dhënat dhe statistikat zyrtare të DKA-së së komunës së Prishtinës për vitin shkollor 2016/2017, të cilat janë dorëzuar në muajin maj 2017.

Gjithsej	70	22987	22451	45438
-----------------	-----------	--------------	--------------	--------------

Shumica e shkollave në Komunën e Prishtinës punojnë në dy ndërrime, por ka edhe një numër të konsiderueshëm të shkollave që punojnë vetëm në një ndërrim.

Është me rëndësi të përmendet se në kuadër të disa SHFMU-ve ekzistojnë paralele të ndara fizike, të cilat funksionojnë në kuadër të shkollave amë, por ekzistojnë në lokacione të ndryshme, prandaj numri i objekteve fizike të SHFMU-ve është më i madh se 42 (të gjitha këto detaje mund të gjenden në Shtojcën 2 të këtij dokumenti). Në kuadër të disa SHFMU-ve në zonat e thella rurale të komunës së Prishtinës funksionojnë 22 paralele në të cilat zhvillohet mësimi i kombinuar, në të cilat përfshihen 31 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 29 nxënës të gjinisë femërore.

Gjithashtu duhet përmendur që në komunën e Prishtinës ekziston edhe një shkollë e mesme e lartë profesionale publike (Shtjefën Gjeçovi), e cila nuk menaxhohet nga komuna e Prishtinës, por është nën menaxhimin e agjencisë përkatëse për arsimin profesional.

Përveç IEAA-ve të sipër-përmendura, në komunën e Prishtinës veprojnë edhe rreth 40 institucione parashkollore private me gjithsej 1702 fëmijë, 7 institucione arsimore private të nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasa I-IX) dhe 9 institucione arsimore private të nivelit të arsimit të mesëm të lartë (klasa X-XII) me gjithsej 2316 nxënës, të gjitha këto të licencuara nga MASHT-i.

Në kuadër të DKA-së së komunës së Prishtinës janë 18 të punësuar, përfshirë dhe pozitën e drejtorit të DKA-së. Kurse, në kuadër të IEAA-të publike të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar të komunës së Prishtinës, DKA ka të punësuar gjithsej 3170 persona. Të dhënat e të punësuarve sipas llojit, nivelit dhe gjinisë janë të prezantuar në tabelën në vijim:

Numri i personelit në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese publike të nivelit të arsimit parauniversitar në komunën e Prishtinës					
Niveli i institucionit	Gjinia	Lloji i personelit			Gjithsej personel
		Mësimdhënës	Personel administrativ	Personel ndihmës	
Institucione parashkollore	M	27	3	29	59
	F	188	15	52	255
	GJ	215	18	81	314
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta	M	365	49	203	617
	F	1267	63	94	1424
	GJ	1632	112	297	2041
Shkolla të mesme të larta	M	250	23	103	376
	F	393	16	30	439
	GJ	643	39	133	815
Gjithsej personel	M	642	75	335	1052
	F	1848	94	176	2118
	GJ	2490	169	511	3170

Sipas të dhënave zyrtare të DKA-së, vetëm 3 mësimdhënës janë të pakualifikuar sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

Gjithashtu, vlen të përmendet se në kuadër të personelit të IEAA-ve publike të Prishtinës janë të punësuar 14 psikologë, të cilët mbulojnë 27 SHFMU dhe SHML, ndërsa janë të punësuar edhe 2 pedagogë, njëri mbulon 8 IP-të publike dhe njëri mbulon 1 SHFMU.

3.2. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë

Të gjitha IEAA-të e komunës së Prishtinës i kanë Planet Zhvillimore të Shkollave (PZHSH), të hartuara për një periudhë trevjeçare, të cilat rishikohen çdo gjashtë muaj, si dhe i kanë të themeluara dhe funksionale Këshillat Drejtuese të shkollave.

Mësimi tërëditor zbatohet në gjashtë shkolla publike të Prishtinës, ndërsa në gjashtë tjera përdoret ditari digjital.

Vetëm në tri shkolla të mesme profesionale janë caktuar në mënyrë zyrtare koordinatorët e cilësisë, ndërsa në disa shkolla e kryejnë funksionin e koordinatorit të cilësisë persona të caktuar, por që ende nuk janë zyrtarizuar.

Sa i përket anës buxhetore, edhe Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2017 ka kaluar nëpër sfidat e njëjta sikurse edhe komunat e tjera në Kosovë. Kësisoj, gjatë vitit 2017 kanë qenë të planifikuara për zhvillim profesional të mësimdhënësve (ZHPM) vetëm 5000€ nga DKA e Prishtinës. Realisht, DKA nuk ka qenë në gjendje të merr përgjegjësitë në këtë fushë, ndërkohë që, aftësimet e zhvilluara me fondet e MASHT nuk përkrijnë në masë të duhur me kërkesat dhe nevojat e mësimdhënësve e të shkollave, pikërisht për shkak të planifikimit të centralizuar dhe larg shkollës.

Në fushën e menaxhimit dhe të sigurimit të cilësisë në arsim në komunën e Prishtinës në disa vitet e fundit është punuar në luftimin e politizimit të arsimit dhe për respektimin e plotë të ligjeve dhe të akteve nënligjore në procesin e menaxhimit të arsimit. Pos kësaj, është siguruar transparencë e plotë në procesin e rekrutimit të personelit dhe në pranimin e fëmijëve / nxënësve në ato institucione edukative e arsimore (si çerdhet dhe shkollat e mesme të larta) që kanë pasur kërkesë më të madhe për regjistrim. Para së gjithash kjo është arritur duke zhvilluar procedura efikase e transparente të rekrutimit të personelit dhe instrumentet përkatëse. Pastaj, si rekrutimi dhe regjistrimi janë bërë me përfshirjen e komunitetit, prindërve ose të ekspertëve të jashtëm të pavarur. Kjo ka bërë që të kthehet besimi i prindërve e të komunitetit në ofrimin e shërbimeve arsimore, në fuqizimin e prindërve, dhe në funksionimin më të mirë të organeve qeverisëse shkollore.

Më tutje është punuar në sigurimin e personelit të kualifikuar për shkollat dhe institucionet parashkollore në komunën e Prishtinës, përfshirë edhe për profesionet deficitare. Kështu, nevojat e shkollave për mësimdhënës të matematikës, të gjuhës angleze, të teknologjisë informative, e kështu me radhë tashmë plotësohen pothuajse në masën 100%.

Pos kësaj, autoritetet dhe institucionet edukative e arsimore janë angazhuar për krijimin e një kulture të re bashkëpunuese në të gjitha nivelet, si në mes të institucioneve (me MASHT-in, inspektoratin, shkollat, e me çerdhet), ashtu edhe në mes të prindërve, nxënësve, mësimdhënësve e komunitetit. Si rezultat është përmirësuar komunikimi me këto entitete dhe është shtuar llogaridhënia në institucione. Në këtë drejtim kanë ndihmuar transparenca, informimi, raportimi i rregullt dhe qasja përkrahëse ndaj shkollave.

Në suaza të përgjegjësisë dhe kompetencave të veta ligjore, DKA është angazhuar në organizimin dhe përkrahjen e programeve të shumta të aftësimin për mësimdhënës / edukatorët dhe për menaxhmentin e institucioneve arsimore. Të gjithë kësaj i ka parapri një fushatë vetëdijesuese për domosdonë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Në vijim janë planet për përmirësimin e funksionimit të aktiveve profesionale dhe të menaxhmentit të mesëm. Shumica e programeve të aftësimin janë organizuar në fushën e menaxhimit të institucioneve arsimore, lexim-shkrimit dhe në metodologjitë lëndore. Drejtorja ka përkrahur nisma që ndikojnë në zhvillimin profesional me bazë në shkollë dhe në përputhje me kërkesat dhe nevoja e mësimdhënësve për zhvillim profesional. Kjo ka ndikuar në shmangien e pjesëmarrjes së

mësimdhënësve në trajnime në bazë të vlerësimeve arbitrare të menaxhmentit të shkollës e të komunës dhe duke u bazuar në nevojat e planet personale zhvillimore të mësimdhënësve. Ndër rezultatet e angazhimeve në sektorin e arsimit në katër vitet e fundit ka qenë edhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parafillor në masën 76% të fëmijëve të moshës përkatëse në komunën e Prishtinës.

Pos kësaj, DKA Prishtinë ka vendosur të rrisë cilësinë dhe pjesëmarrjen në arsim nëpërmjet të organizimit të mësimi tërëditor atje ku ka mundësi. Në këtë mënyrë, prej vitit 2016 është pilotuar mësimi tërëditor në gjashtë shkolla të komunës së Prishtinës. Për të përkrahur punën e shkollave pilot DKA ka caktuar nga një koordinator të jashtëm për mësimin tërëditor. Ata kryesisht përkrahin mësimdhënësit në planifikimin dhe në zbatimin e aktiviteteve plotësuese të mësimi tërëditor dhe punojnë për ngritjen profesionale të mësimdhënësve të këtyre shkollave, duke organizuar trajnime dhe duke organizuar mësimin e punën bashkëpunuese në shkollë. Informacionet e para kthyes nga shkollat tregojnë se mësimi tërëditor ka ndihmuar në përmirësimin e performancës dhe në rritjen e interesimit të nxënësve për këtë formë të mësimi. Ndër problemet e vërejtura përfshihen, pakënaqësi të disa mësimdhënësve me orarin e zgjatuar krahasuar me kolegët e tyre nga shkollat e tjera, mungesa e përkrahjes së mjaftueshme me mjete materiale, mungesën e bashkëpunimit dhe të qasjes aktive të prindërve ndaj kësaj nisme e të tjera.

Ekzistimi i planeve kombëtare zhvillimore, si të atyre qeveritare dhe në sektorin e arsimit janë parë gjithashtu si mundësi nga pjesëmarrësit e planifikimit të strategjisë zhvillimore të arsimit në Prishtinë. Kështu, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021⁶, parasheh zhvillimin e kapitalit njerëzor si prioritet numër një. Një gjë e tillë, ndikon pozitivisht, qoftë edhe në rrafsh simbolik, në trajtimin e nismave pozitive arsimore nga njësitë vendore të menaxhimit të arsimit. Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017 – 2021⁷ është parë si një mundësi tjetër, pasi që ofron një kornizë afirmative dhe udhërrëfyes për planifikimin e edukimit dhe arsimit në nivel vendor. Ky plan mundëson planifikim më të mirë të masave konkrete në mënyrë që të sigurohet sinergji në mes të nismave në nivele të ndryshme të organizimit të qeverisjes në vend.

Janë disa nisma në fushën e menaxhimit në nivel qendror që janë parë si oportunitete për pjesëmarrësit e procesit të planifikimit. Këto janë: fillimi i zbatimit të vlerësimit të performancës së shkollës, aftësimi i mësimdhënësve me bazë në shkollë (për dallim nga trajnimet e deritanishme në seminare jashtë shkollës), zhvillimi dhe zbatimi i sistemit për orientim në karrierë e të tjera.

Grupet për planifikim konstatuan se duhet punuar edhe më shumë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e të të nxënësve nëpër shkolla. Padyshim se rezultatet e testit PISA 2015 vetëm sa e kanë konfirmuar bindjen për cilësinë e pamjaftueshme të shkollimit në Kosovë. Një gjendje e këtillë sipas pjesëmarrësve mund të kishte rezultuar nga disa faktorë: mungesa e planifikimit dhe e përgatitjes së mirëfilltë për mësim nga ana e mësimdhënësve, pamundësia për zbatimin në mësim të teknikave e strategjive të reja të mësuara në programe aftësimi, rezistenca e një numri të mësimdhënësve për t'u aftësuar për kurrikulat e reja, ambientimi i mësimdhënësve në zonën e komoditetit, si dhe mungesa e një sistemi të llogaridhënies në sektorin e arsimit në përgjithësi. Pos kësaj, të dhënat statistikore tregojnë për rënie të vijueshmërisë së nxënësve në mësim, e përcjellë me rënie të interesimit (mbase për arsye se shkollimi nuk po mund të përcjellë trendet teknologjike jashtë shkollës) dhe të tjera.

Një fushë tjetër që kërkon angazhim përmbajtësor është fusha e arsimit profesional. Në këtë fushë janë konstatuar arritje por edhe mangësi, të cilat do të duhej trajtuar në këtë plan

⁶ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

⁷ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf

zhvillimor të arsimit. Në këtë kuptim janë theksuar mungesa e mekanizmave për koordinimin e punës praktike në arsim në nivel komunal, mungesa e angazhimit të nxënësve në punë praktike, mungesa e punëtorive dhe e mjeteve të punës (përkundër disa përparimeve të shënuara), mungesa e autonomisë së shkollave për gjenerimin dhe përdorimin e mjeteve nga puna praktike, e të tjera.

Në të njëjtën kohë, ishin edhe rrethanat e tjera të jashtme si situata e përgjithshme politike në kryeqytet, kompetencat e përziera ligjore në mes niveleve të organizimit të arsimit, mungesa e buxhetit, organizimi jo i mirë i reformës kurrikulare, mungesa e personelit të mjaftueshëm në DKA e të tjera që ndikuan në performancën e sistemit arsimor në nivelin e dëshiruar.

Në rrafshin institucional u theksuan: performanca jo e mirë në paralelet e ndara dhe në shkollat e vogla rurale (në radhë të parë për shkak të mungesës së konkurrencës së dijes, monitorimit dhe llogaridhënies), mos-zbatimi i vlerësimit të performancës në nivel shkolle, mungesa e personelit për monitorim/mentorim, si dhe mungesa e shërbimeve profesionale në shkolla. Gjendja e këtillë në menaxhimin e institucioneve dhe në sigurimin e cilësisë paraqet sfidë për procesin e planifikimit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës.

Sfidat kryesore:

- Mungesa e kapaciteteve profesionale në nivel të DKA-së dhe të IEAA-ve.
- Mungesa e llogaridhënies nëpër shkolla.
- Mungesa e mekanizmave për sigurimin e cilësisë.
- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e funksionit të DKA-së.
- Funksionimi i paraleleve të ndara dhe i shkollave me numër të vogël të nxënësve në zonat rurale.
- Mosaplikimi i qasjeve dhe strategjive të reja të fituara në programet e zhvillimit profesional.

3.3. Zbatimi i kurrikulës së re

Grupi koordinues dhe grupi i zgjeruar për planifikim identifikuan zbatimin e kurrikulës së re si një ndër fushat më të rëndësishme të punës për trajtim nga planifikimi strategjik. Kjo për dy arsye kryesore: në njërin anë, zbatimi i deritanishëm, qoftë në shkollat pilot në të cilat është zbatuar kurrikula, po edhe në ato ku kanë filluar përgatitjet për shtrirje të zbatimit të saj, është përcjellë me vështirësi dhe lëshime të shumta që kanë ndikuar të krijohet një dozë mosbesimi ndër faktorët të cilët duhet të zbatojnë kurrikulën në shkolla. Në anën tjetër, dhe përkundër vështirësive të shumta, shkollat pilot kanë treguar një cilësi të re të punës e të bashkëpunimit si ndërmjet mësimdhënësve ashtu edhe në mes të nxënësve.

Prej fillimit të pilotimit të kurrikulës së re e deri në vitin shkollor 2016/2017 në shkollat publike të Prishtinës është bërë zbatimi provues i kurrikulës së re në dy SHFMU dhe pesë SHML.

Sipas të dhënave të siguruara nga DKA Prishtinë, në shtatë shkollat që cilat kanë filluar zbatimin e Kurrikulës së Re, nga viti 2013 deri në vitin 2016, janë trajnuar pothuajse të gjithë mësimdhënësit e këtyre shkollave pilotuese, apo rreth 400 mësimdhënës. Ndërsa në vitin 2017 janë trajnuar rreth 856 mësimdhënës nga të gjitha shkollat në kuadër të përgatitjeve për shtrirjen e zbatimit të kurrikulës së re në të gjitha shkollat për klasat 0, 1, 5 dhe 10 gjatë vitit shkollor 2017/2018. Tashmë janë aftësuar mbi 40 trajnerë për kurrikulën e re në nivel të komunës së Prishtinës.

Ndër arritjet e pilotimit të kurrikulës së re duket të jenë mobilizimi më i madh i përcjellë me një kulturë më bashkëpunuese në mes të mësimdhënësve, aktivizimi i aktiveve profesionale dhe zhvillimi i aktiviteteve me bazë në shkollë. Kurrikula e re duket se ka hapur edhe mundësi të shumta për zhvillimin e arsimit në Prishtinë. Shtrirja e zbatimit të saj në të gjitha shkollat, që pritet të ndodh prej vitit shkollor 2017-18 pritet se do të krijojë një kontekst të ri që do të dinamizojë tërë sistemin dhe faktorët arsimor në komunë. Pos kësaj mendohet se kurrikula e re

do të sjellë edhe trajnime të reja të organizuara nga niveli qendror në qasjet e elementet e reja që sjellë kurrikula e re si kompetencat, rezultatet kryesore mësimore, mësimi i integruar, vlerësimi formativ, bashkëpunimi në kuadër të fushave kurrikulare e të tjera. Po ashtu pritet që tekstet shkollore të shihen në një dritë të re, si elemente ndihmëse në shërbim të ndërtimit të kompetencave të nxënësve dhe jo si zëvendësim i kurrikulave shtetërore, siç është praktika ekzistuese në shkolla.

Sfidat kryesore:

- Mungesa e harmonizimit/bashkëpunimit mes të gjitha palëve me interes MASHT-DKA-IPK-Inspektorati-Shkollë.
- Mungesa e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë në mes të palëve me interes për zbatimin në praktikë të kurrikulës së re.
- Rezervat dhe paqartësitë e mësimdhënësve ndaj ndryshimeve që sjellë KKK dhe KB, për shkak të pasigurisë për përdorimin e metodologjive bashkëkohore.
- Mungesa e trajnimeve për zhvillim profesional në zbatimin cilësor të kurrikulës ZHPMB (BEP dhe GIZ).
- Mungesa e infrastrukturës, mjeteve dhe teksteve shkollore, të harmonizuara me programet lëndore, për zbatim të kurrikulave.

Zbatimi i kurrikulës së re mund të përcillet dhe të ndikohet nga dobësitë e njëjta që e kanë përcjellë edhe zbatimin e kurrikulës së tanishme. Kjo në rend të parë për shkak të mungesës dhe cilësisë jo të mirë të teksteve (sidomos në arsimin profesional), mungesës së teknologjisë dhe infrastrukturës shkollore për mësim bashkëkohor, si dhe trajnimeve jociësore dhe jorelevante. Pjesëmarrësit ishin dakord se hapat e parë në organizimin e përgatitjeve për shtrirjen e kurrikulës së re në të gjitha shkollat nuk ishin shumë premtuese. Ata konstatuan se mungon transparenca në procesin e përgatitjeve, aftësimi i mësimdhënësve bëhet në mënyrë të përshpejtuar, trajnerët nuk janë përgatitur sa duhet për të shpjeguar dhe aftësuar mësimdhënësit për një projekt kaq të rëndësishëm e kompleks, mungon përkrahja e duhur materiale si për trajnime dhe për zbatim të kurrikulës në shkollë e të

tjera. Zbatimi i kurrikulës paraqitet një sfidë e vërtetë, sidomos në shkollat e qytetit të të tri niveleve të cilat zakonisht janë të mbingarkuara me numër të madh të nxënësve në klasë.

3.4. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore

Në komunën e Prishtinës shumica (rreth 95%) e shkollave kanë qasje në internet; vetëm tri shkolla nuk kanë qasje në internet⁸. Të gjitha shkollat e Prishtinës janë të pajisura me kompjuterë. Shumica e shkollave kanë kabinete lëndore (të biologjisë, kimisë, fizikës, etj.), me përjashtim të tri shkollave (“Elena Gjika”, “Azemi e Salihu” dhe “Dëshmorët e 1921”). Shumica e shkollave profesionale janë të pajisura me punëtori profesionale, mirëpo në disa shkolla mungojnë disa punëtori (në SHML “Dr. Ali Sokoli” mungon kabineti i stomatologjisë; në SHML “28 Nëntori” nuk ka punëtori për lëmin e ndërtimit; në SHML “7 Shtatori” nuk ka punëtori për praktikë profesionale). Gjithsej 23 institucione edukativo-arsimore të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të komunës së Prishtinës janë të pajisur me biblioteka. Vetëm dy shkolla përdorin platforma të mësimin online ose e-mësimin (SHFMU “Faik Konica” dhe SHFMU “Model”). Gjithsej 33 shkolla të Prishtinës kanë salla të edukatës fizike dhe 24 nga këto shkolla i kanë sallat të pajisura me rekuizita sportive.

⁸ SHFMU “Azemi e Salihu”, SHFMU “Fan Noli”, SHFMU “Dëshmorët e 1921”.

Përderisa janë bërë përparime në sigurimin e mjediseve të mjaftueshme dhe të këndshme fizike e në furnizimin me kabinate e laboratorë të ndryshëm (sidomos të informatikës e të shkencave natyrore), megjithatë vërehen ngecje në planifikimin dhe menaxhimin e proceseve që do të merreshin me krijimin, furnizimin dhe aplikimin e teknologjisë arsimore për përmirësim të

Sfidat kryesore:

- Pajisje jo të mjaftueshme të teknologjisë së informimit e të komunikimit në shkolla.
- Mësimdhënës të papërgatitur për krijim dhe përdorimin kreativ të resurseve dhe të teknologjisë në funksion të të nxënësve.
- Buxhet jo i mjaftueshëm i dedikuar për pako të teknologjisë arsimore.
- Mungesë e aplikacioneve mësimore digjitale.

mësimdhënies. Pa përdorimin e duhur të teknologjisë arsimore nuk mund të ketë mësim autentik e relevant, as pjesëmarrje aktive të nxënësve, as mësim përmes projekteve e të tjera. Mungesën relative të teknologjisë arsimore, mësimdhënësit e kompensojnë duke përdorur resurset e veta, duke bashkëpunuar me prindër, duke aktivizuar nxënësit e të tjera. Pa dyshim, vetëm një qasje sistematike ndaj kësaj çështjeje mund të ndihmojë për ndryshimin substancial dhe të domosdoshëm të gjendjes.

Përdorimi më i mirë i teknologjive arsimore, sipas pjesëmarrësve, përfshirë nëpërmjet të

realizimit të digjitalizimit të shkollave, organizimit të e-Mësimin, si dhe përshtatjen e shkollës kërkesave të shtuara të nxënësve për informacion të shpejtë e për mësimdhënie më atraktive. Të gjitha këto, në fund, mund të ndikojnë edhe në krijimin e një mjedisi më miqësor mësimor dhe zbatimin më të mirë të kurrikulave. Para realizimit të këtyre mundësive të shumta për përmirësimin e teknologjisë arsimore në shkolla dalin sfida dhe rreziqe të ndryshme si: mungesa e konsiderueshme e buxhetit, infrastruktura e papërshtatshme për përdorim optimal të teknologjive të reja arsimore dhe të tjera. Pikërisht këto sfida e rreziqe janë edhe objekt trajtimi i strategjive të këtij plani zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës.

3.5. Përfshirja në edukimin parashkollor

Sipas të dhënave të DKA-së dhe statistikave në dispozicion nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, në komunën e Prishtinës në edukimin parashkollor (0-5 vjeç), pa përfshirë parafillorët, në institucionet publike, në ato me bazë në komunitet dhe në institucionet publiko-private janë të përfshirë 1575 fëmijë apo rreth 9.40%. Këtu nuk janë të përfshirë fëmijët që vijnë në këtë nivel edukimi në institucionet parashkollore private në komunën e Prishtinës. Në komunën e Prishtinës në nivelin parafillor (klasën përgatitore), në institucionet parashkollore dhe në shkollat fillore janë të përfshirë gjithsej 2778 fëmijë apo rreth 79.25% të fëmijëve të grupmoshës përkatëse. Këtu nuk janë të përfshirë fëmijët që vijnë në këtë nivel edukimi në institucionet private në komunën e Prishtinës.

Edukimi parashkollor në Kosovë, përfshirë Prishtinën, vuan nga probleme tërësisht substanciale, si përfshirja tejet e ulët e fëmijëve dhe mungesa relative e cilësisë së shërbimeve. Edhe po të mos ishin treguesit e tjerë për cilësinë dhe kushtet e punës nëpër institucione të edukimit parashkollor, do të mjaftonte fakti për përfshirjen e më pak se 10 % të fëmijëve në edukimin parashkollor për të dhënë alarmin për nevojën e intervenimit më të fokusuar e sistematik në këtë fushë. Edhe Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017 - 2021 e trajton çështjen e përfshirjes në edukimin parashkollor në objektivin e parë strategjik. Një ndër arsytet për një gjendje të këtillë, sipas pjesëmarrësve, është edhe pamundësia e punësimit të numrit plotësues të edukatorëve për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në EPSH.

Sipas të dhënave nga DKA Prishtinë, gjatë tri viteve të fundit janë shtuar kapacitetet pranuese të institucioneve parashkollore në komunë për rreth 50%. Janë ndërtuar tri kopshte të reja; janë themeluar dy kopshte me bazë në komunitet; ka pasur nisma për të themeluar kopshte në bashkëpunim me partnerë privat; janë zhvilluar dhe aplikuar programe edukative alternative që gjenerojnë të hyra për edukimin parashkollor. Pos kësaj, është mundësuar participimi i bizneseve dhe prindërve në funksionimin e IPSH-ve ekzistuese dhe është punuar për ofrimin e shërbimeve të integruara në IPSH. Kujdes i veçantë i është kushtuar sigurimit të drejtësisë dhe transparencës gjatë rekrutimit të personelit dhe pranimit të fëmijëve në kopshte.

Sfidat kryesore:

- Mungesë e kapaciteteve infrastrukturore dhe materialeve.
- Fonde të pamjaftueshme për rritjen e përfshirjes dhe cilësisë në EPSH për fëmijët 2-5 vjeç.
- Mungesë e programeve të trajnimit në fushën e edukimit parashkollor.
- Mungesë e zbatimit të metodologjive pedagogjike për edukim parashkollor.
- Mungesë e shërbimeve shëndetësore-psiko-pedagogjike.
- Mungesë e zbatimit të standardeve të organizimit të punës edukative-arsimore në IP-ve

Pos kësaj, DKA Prishtinë ka përkrahur projekte aftësuese për aplikimin e metodologjive bashkëkohore në EPSH dhe rrjetëzimin në mes të institucioneve e edukatorëve për zhvillim profesional dhe shkëmbim përvojash.

Përkundër arritjeve kanë vazhduar vështirësi të shumta në EPSH në Prishtinë. Pos atyre që u përmenden më lartë është shënuar mungesë e shërbimeve profesionale (me psikologë e pedagogë në kopshte), mungesa e objekteve dhe e kushteve të mira të punës në objektet ekzistuese, mungesa e mjeteve për punë në kopshte e çerdhe, si dhe mungesa e programeve të mjaftueshme pedagogjike dhe e trajnimeve në EPSH.

3.6. Mjedis i sigurt dhe miqësor në shkollë

Në komunën e Prishtinës janë pesë institucione parashkollore, 23 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe shtatë shkolla të mesme të larta që kanë nevojë për renovim urgjent. Me përjashtim të shkollës “Dëshmorët e 1921” në Balaj, të gjitha shkollat e Prishtinës i kanë oborret e rrethuara, ndërsa 25 institucione të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë të pajisur me kamera të sigurisë.

Sfidat kryesore:

- Ekzistimi i dhunës fizike dhe psikike në shkolla dhe rreth tyre.
- Mbyllja e shkollës dhe qasja konservative ndaj trendëve të reja.
- Infrastruktura jo e mirë shkollore dhe përreth shkollës.
- Mungesa e përgatitjes profesionale e pedagogjike të mësimitshënësve dhe edukatorëve.

Bazuar në raportimet e vitit të kaluar shkollor në DKA, janë raportuar mbi 100 raste të dhunës ndaj nxënësve, mbi 100 raste të dhunës ndërmjet nxënësve, rreth 20 raste të përdorimit të substancave narkotike nga nxënësit dhe 10 raste të armëmbajtjes nga nxënësit.

Në Prishtinë është punuar për krijimin e një mjedisi pozitiv të të nxënësve. Në këtë kuptim kanë ndihmuar investimet në infrastrukturë, rregulloret komunale që rregullojnë menaxhimin e shkollës dhe raportet ndërnjerëzore në shkollë, aftësimin e

mësimitshënësve në fushën e të drejtave të njeriut dhe në qasjet e reja me nxënësin në qendër. Një hap vendimtar është realizuar me hapjen dhe funksionalizimin e shkollave të reja si “Shkolla Model” dhe “Shkolla e Gjelbër”. Këto shkolla të përkrahura nga MASHT, përkatësisht Banka Botërore, kanë shërbyer si model jo vetëm të infrastrukturës fizike, por edhe

të marrëdhënieve të reja në mes të menaxhmentit, mësimdhënësve dhe nxënësve edhe në shkallë kombëtare e në rajon. Cilësia e komunikimit dhe liria e shprehjes së nxënësve është shtuar dukshëm si gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Klasat kanë fituar një fizionomi të re të një mjedisi më të ngrohët, më dinamik dhe shumëngjyrësh.

Këto arritje megjithatë nuk e karakterizojnë tërë sistemin e shkollave në Prishtinë. Ende mbeten mjedise të pasigurta, të ftohta, jomiqësore për nxënësit, dhe mosmarrëveshje e imponime të shpeshta në të gjitha relacionet ndërnjerëzore në shkollë. Prishtina, në njëfarë mënyre, tregon elemente të shkollave më moderne evropiane por edhe ngecje të konsiderueshme në fushën e infrastrukturës dhe të marrëdhënieve ndërnjerëzore, sidomos në shkollat rurale dhe në paralelet e ndara.

Ende shkolla mbetet relativisht e mbyllur dhe jotransparente ndaj komunitetit, mungon kompetenca për trajtimin e incidenteve që përfshijnë nxënësit, ende ushtrohet dhunë fizike dhe psikike ndaj nxënësve, por edhe ndaj mësimdhënësve, e të tjera. Jo të gjitha shkollat kanë psikologë, bibliotekistë, pedagogë dhe shërbime të tjera profesionale që do të ndikonin pozitivisht në krijimin e një mjedisi të mirëfilltë arsimor në shkollë. Njëkohësisht, rreziku vjen edhe nga mungesa e bashkëpunimit të duhur në mes të autoriteteve arsimore vendore dhe qendrore dhe i organeve të sigurisë publike dhe të drejtësisë. Mungesa e kushteve buxhetore për ofrimin e sigurimit fizik 24 orësh në shkolla, pamundësia e furnizimit me pajisje e materiale të bollshme mësimore dhe mungesa e hapësirave atraktive të brendshme e të jashtme e bëjnë mjedisin shkollor në Prishtinë ende të pasigurt.

4. Strategjitë për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës

Anëtarët e grupit për planifikim u përcaktuan për vizionin dhe misionin në vazhdim për pesë vitet e ardhshëm për sektorin e arsimit në Prishtinë:

Vizioni: Arsimi në Prishtinë model në Kosovë dhe në rajon për sigurimin e shërbimeve cilësore edukative arsimore për fëmijët dhe të rinjtë. Shkolla në Prishtinë është mekanizëm i fuqishëm inovativ me mjedis të sigurt, miqësor dhe të avancuar teknologjik që mobilizon nxënësit, mësimdhënësit, menaxhmentin, prindërit, bizneset, komunitetin në zhvillimin e kompetencave të secilit nxënës në përputhje me arritjet më të reja të dijes e të vlerave.

Misioni: Arsimi dhe institucionet arsimore në Prishtinë janë të përkushtuara për të siguruar shërbime cilësore arsimore dhe shkathtësi për arsimim gjatë gjithë jetës në një mjedis atraktiv, të sigurt dhe miqësor për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Arsimi në Prishtinë ofron kompetenca për tregun e punës, për jetë dhe shkollim të mëtejshëm, si dhe mundësi të barabarta dhe mobilitet social për fëmijët nga të gjitha grupet dhe shtresat e qytetarëve të Komunës së Prishtinës.

Vlerat e arsimit në Prishtinë: Në arsimin e Prishtinës respektohet individualiteti, diversiteti, mirëqenia dhe suksesi i fëmijëve. Po ashtu me rëndësi është përkushtimi, dashuria për profesionin dhe përgjegjshmëria e punëtorëve arsimorë.

Parimet:

- Parimi i haptësisë, transparencës dhe fleksibilitetit.
- Parimi i monitorimit, masave përcjellëse, matjes dhe vlerësimit të performancës institucionale.
- Parimi i barazisë dhe trajtimit të barabartë për të gjithë.

Në funksion të realizimit të vizionit dhe misionit të përkufizuar më lartë, janë përcaktuar nga një objektivi strategjik për secilën fushë të intervenimit:

Objektivat strategjike:

- OS 1. Zhvillohen kapacitetet njerëzore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshëm të cilësisë në arsimin e Komunës Prishtinës.
- OS 2: Të zbatohet në mënyrë të planifikuar dhe cilësore kurrikula e re me përfshirje të të gjitha palëve të përfshira.
- OS 3: Sigurohet teknologjia e duhur arsimore që mundëson kushte dhe procese optimale mësimore për mësimdhënësit dhe nxënësit për të nxënë efektiv.
- OS 4: Përmirësimi i përfshirjes dhe i cilësisë së shërbimeve në edukimin parashkollor në Komunën e Prishtinës.
- OS 5: Të realizohet një shkollë e sigurt, miqësore dhe gjithëpërfshirëse në Komunën e Prishtinës në të cilën secili nxënës gëzon kushte optimale për zhvillim personal.

Për arritjen e këtyre objektivave strategjike janë menduar 23 rezultate të pritura, që në të vërtetë shënojnë përkushtimin dhe zotimin e autoriteteve dhe të shkollave të Prishtinës për avancimin e arsimit në këtë komunë. Njëkohësisht, janë identifikuar 69 masa dhe me qindra aktivitete konkrete për operacionalizimin dhe zbatimin e rezultateve të pritura. Në vijim paraqiten dhe përshkruhen këto masa dhe aktivitete për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës në pesë vitet e ardhshme.

5. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë

Objektivi Strategjik 1. Zhvillohen kapacitetet njerëzore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshëm të cilësisë në arsimin e Komunës Prishtinës

Arsimi në Prishtinë, si edhe gjithandej nëpër Kosovë, po kalon nëpër një fazë të rëndësishme dhe shumë komplekse të zhvillimeve arsimore, përfshirë sfidat e zbatimit të kurrikulës së re dhe vështirësitë gjatë përshtatjes së administratës për zbatimin e përgjegjësive të bartura në kuadër të procesit të decentralizimit të arsimit në Kosovë (në veçanti lidhur me edukimin parashkollor dhe zhvillimin profesional të mësimitdhënësve). Edhe pa zhvillime të këtylla intensive, arsimi vetvetiu është një sistem kompleks që ngërthen ndërveprimin e faktorëve të shumtë (mësimitdhënësit, prindërit, mjetet mësimore, objektet shkollore e të tjera) që kërkojnë mobilizim të shtuar për bashkërenditje dhe menaxhim efikas.

Grupi punues i autoriteteve arsimore në Prishtinë janë përcaktuar për trajtimin e problemeve të menaxhimit dhe të sigurimit të cilësisë brenda një fushe të përbashkët të intervenimit. Sado e pazakontë si qasje në trajtimin e problemeve arsimore, një trajtim i këtyllë i problemeve të menaxhimit e të cilësisë doli se siguronte zgjidhje më të qëndrueshme për të dyja fushat. Si pjesë e sigurimit të cilësisë, kjo fushë e intervenimit përfshinë edhe masat për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, si një nga përgjegjësitë kryesore të komunës në sektorin e arsimit.

Problemi kryesor i identifikuar në fushën e menaxhimit e të sigurimit të cilësisë në arsimin e Prishtinës ishte mungesa e resurseve kompetente e cilësore humane për menaxhim efikas e cilësor të arsimit në Komunën e Prishtinës dhe të procesit mësimor në klasa.

Rezultatet e pritura

Për trajtimin e sfidave të identifikuar, zyrtarët komunalë, drejtorët dhe mësimitdhënësit e shkollave, të përfshirë në procesin e planifikimit, kishin formular një sërë rezultatesh, zotime për ndryshim, që do të ndihmonin në tejkalimin e sfidave e të problemeve. Kjo fushë e intervenimit i mban në fokus të intervenimit aspektet e resurseve njerëzore, si zyrtarët komunalë e mësimitdhënësit, mirëpo nuk harrohet as krijimi i zgjidhjeve dhe mekanizmave institucional për menaxhim efikas dhe për sigurim të cilësisë. Një segment i rëndësishëm i përcjellë me strategji të veçanta është edhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm të arsimit. Njëkohësisht, llogaridhënia e përgjegjshmëria individuale e institucionale trajtohet në masat e kësaj fushe, përfshirë cilësinë dhe efikasitetin e punës në shkollat e vogla rurale dhe në paralelet e ndara.

Rezultatet:

- Ekziston personel i mjaftueshëm dhe i kualifikuar në nivel të DKA-së dhe të IEAA-ve.
- Zbatohen mekanizmat që sigurojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien në arsim në Komunën e Prishtinës.
- Ekzistojnë dhe zbatohen mekanizmat për sigurimin e cilësisë.
- Zbatohen procedura të financimit të qëndrueshëm të arsimit në Komunën e Prishtinës.
- Është siguruar funksionim efikas në paralelet e ndara dhe në shkollat e vogla rurale.
- Mësimitdhënësit zbatojnë strategjitë mësimore dhe shkathtësitë e fituara në programet e zhvillimit profesional.

Përshkrimi i masave

Në vijim jepet përshkrimi i masave dhe aktivitetet e parapara që do të shërbejnë për realizimin e rezultateve përkatëse për tejkalimin e sfidave dhe për përmirësimin e arsimit në Komunën e Prishtinës në fushën e menaxhimit dhe të sigurimit të cilësisë.

Rezultati 1.1. Ekziston personel i mjaftueshëm dhe i kualifikuar në nivel të DKA-së dhe të IEAA-ve.

Masa 1.1.1. Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA.

Fillimisht do të bëhet vlerësimi i gjendjes lidhur me kompetencat dhe kualifikimet e personelit në DKA dhe në IEAA duke iu referuar misionit institucional DKA, shkollë, IP dhe trendëve në sektorin e arsimit. Raporti përfshin vlerësimin e nevojave për zhvillim profesional, rikualifikim dhe punësime të reja për realizuar funksionet e kërkuara nga DKA dhe IEAA-të në Komunën e Prishtinës. Në bazë të rezultateve të raportit do të rishikohen, hartohen dhe të miratohen kriteret për rekrutimin e personelit në IEAA që do të sigurojnë transparencë, punësim sipas meritës dhe të drejta të barabarta në punësim. Pos kësaj, raporti do të shërbejë për hartimin e programeve të aftësimi-rikualifikimit dhe procedura transparente për rekrutimin e personelit të nevojshëm. Për personelin e rekrutuar do të organizohen programe të aftësimi dhe zhvillimit profesional - trajnim fillestar dhe sipas nevojave të vendit të punës.

Masa 1.1.2. Transferimi (migracioni) i brendshëm i personelit dhe i mësimdhënësve nga një shkollë në një shkollë tjetër.

Transferet bëhen në bazë të kërkesave të mësimdhënësve për transferim prej shkollës në shkollë sipas nevojave personale duke u shkëmbyer një me një dhe sipas ndryshimeve të situatës në institucionet edukative e arsimore në Komunën e Prishtinës: varësisht nga trendet demografike, masat për racionalizimin e shkollave të vogla dhe paraleleve të ndara, transferimi si rezultat i performancës jo të mirë, ndihma profesionale me personel cilësor në shkolla me performancë jo të mirë e të tjera.

Masa 1.1.3. Sistemimi i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare.

Si pasojë e ndryshimeve kurrikulare dhe politikave arsimore, disa mësimdhënës mbesin pa normë apo vend pune. Kështu, duhet menaxhuar situata në bazë të pasqyrës së përgjithshme që vjen nga shkollat dhe bëhet ri-sistemimi i tyre për përdorim efikas të burimeve njerëzore. Një pjesë e mësimdhënësve të këtyre do të shërbejnë si ndihmës-mësimdhënës për të ndihmuar me nxënësit me nevoja të veçanta. Sipas nevojave dhe mundësive, DKA mund të angazhojë edhe mësimdhënës shtesë me orar të plotë ose të pjesshëm për këtë qëllim. Para angazhimit si ndihmës-mësimdhënës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, do të bëhet aftësimi përkatës i mësimdhënësve.

Masa 1.1.4. Rishikimi funksional i Drejtorisë Komunale të Arsimit

Komuna e Prishtinës / Drejtoria Komunale e Arsimit do të organizojë një rishikim funksional të DKA për të vlerësuar sa është organizimi aktual i DKA në funksion të përmbushjes së misionit të DKA në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (Ligji për arsimin parauniversitar dhe Ligji për arsimin në komunitet e Republikës së Kosovës). Rishikimi do të fokusohet në veçanti në rolin monitorues, mbikëqyrës dhe përkrahës të DKA dhe në mundësitë për decentralizim të funksioneve të udhëheqjes e të menaxhimit të arsimit në Komunën e Prishtinës. Për këtë qëllim do të përdoret ekspertizë e pavarur jashtë autoriteteve arsimore në Komunën e Prishtinës.

Rezultati 1.2. Zbatohen mekanizmat që sigurojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien në arsim në Komunën e Prishtinës.

Masa 1.2.1. Krijimi i ekipit profesional në nivel të DKA për monitorimin e vlerësimit të performancës së shkollës.

Në kuadër të raportit për vlerësimin e performancës së shkollës, bëhet mbikëqyrja, kontrolli dhe mbështetja e vazhdueshme deri në arritjen e qëllimeve të përcaktuara në PZSHS dhe legjislacionin në fuqi. DKA themelon dhe bënë aftësimin e anëtarëve të Ekipit Komunal për Koordinimin e proceseve të vlerësimit të performancës së shkollës.

Masa 1.2.2. Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore procesin e vlerësimit të brendshëm.

Shkollat, DKA dhe MASHT punojnë bashkërisht për ndërtimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës. Pas krijimit të ekipeve hartohen dhe zbatohen edhe programet për ngritjen e kapaciteteve të këtyre ekipeve.

Masa 1.2.3. Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm

Ekipi Komunal për vlerësimin e performancës shqyrton raportet e vlerësimit të performancës për të gjitha shkollat. Komisioni i rekomandon DKA-së masat për përmirësimin e gjendjes. Në rast të vonimit të procesit të vlerësimit të mirëfilltë në nivel nacional, Ekipi komunal mund të pilotojë vlerësimin e performancës së shkollës në Komunën e Prishtinës. Masat ndahen në masa përkrahëse (zhvillimi i kapaciteteve, ndihmë profesionale) dhe në masa administrative (shpërblime dhe ndëshkime).

Rezultati 1.3. Ekzistojnë dhe zbatohen mekanizmat për sigurimin e cilësisë.

Masa 1.3.1. Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave.

Shtohet bashkëpunimi i drejtorëve duke realizuar takime të vazhdueshme në funksion të ngritjes së cilësisë, ZHPBSH, shkëmbimit të përvojave të mira, rrjetëzimit, shkëmbimit të praktikave të mira, aftësimin profesional e të tjera.

Masa 1.3.2. Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle.

Në bazë të Kornizës Kombëtare të Kurrikulave dhe PSAK-ut, duhet të sigurohet dhe të paguhet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle, i cili përkrahë menaxhmentin komunal dhe menaxhmentin e shkollës. Në disa raste për dy-tri shkolla do të emërohet / rekrutohet një koordinator i cilësisë.

Masa 1.3.3. Mbikëqyrja/mentorimi dhe fuqizimi i aktiveve profesionale (seksionet).

Koordinatori i cilësisë dhe zyrtarët përkatës të fushës/nivelit të arsimit/edukimit monitorojnë, mentorojnë dhe përkrahin aktivet profesionale në nivel të shkollës.

Masa 1.3.4. Fuqizimi i aktiveve profesionale.

DKA, në bashkëpunim me MASHT, me donatorët dhe me menaxhmentin e shkollave punojnë për ngritjen e kapaciteteve të aktiveve profesionale si strukturë e menaxhimit të mesëm në shkollë. Ky proces përfshin vlerësimin e gjendjes, hartimin e një plani të punës dhe vlerësimin e zbatimit të planit dhe të efektit të tij.

Masa 1.3.5. Themelimi i Këshillit Industrial për Arsimin Profesional në Komunën e Prishtinës për të shtuar bashkëpunimin në mes të shkollave dhe bizneseve në nivel të Komunës

Krijohet Këshilli Industrial për Arsimin Profesional për të realizuar objektivat në vijim: profilizimin e shkollave, zhvillimi i kurrikulave në AAP në shkollat e Prishtinës, organizimi i punës praktike dhe stazhit, zbatimi i projekteve të përbashkëta me rëndësi të ndërsjellë e të

tjera. Këshilli Industrial përbëhet nga bizneset dhe drejtorët e shkollave profesionale me qëllim të shkëmbimit të informatave për trendet e tregut të punës; objektivat zhvillimore të komunitetit; informatat kthyesë për kërkesat e tregut e të tjera. Në kuadër të përgatitjeve për themelim, kontaktohen të gjitha ndërmarrjet afariste dhe institucionet publike me rëndësi për arsimin dhe aftësimin profesional dhe për zhvillimin e kurrikulave dhe të kompetencave të nxënësve. Për punë më të suksesshme caktohen zyra për arkivën, aktivitetet e Këshillit dhe themelohet Sekretariati i Këshillit i përbërë nga zyrtarët përkatës të DKA-së.

Masa 1.3.6. Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me ndërmarrje për realizimin e punës praktike

DKA dhe Këshilli Industrial i Arsimit Profesional punojnë bashkërisht për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve për punë praktike të nxënësve në ndërmarrje. Marrëveshjet hartohen në bazë të UA të MASHT i cili përcakton kushtet dhe kriteret e marrëveshjes. DKA përkrahë zbatimin e marrëveshjeve të këtitilla.

Masa 1.3.7. Përkrahja e punës së kujdestarëve të klasave

Të gjithë kujdestarët e klasave përkrahen në punën e tyre duke i liruar nga një pjesë e obligimeve të mësimdhënies (1-2 orë në javë). Pos kësaj ata përkrahen edhe me përparësi në zhvillimin profesional, në furnizim me pajisje teknologjike, pjesëmarrje në ekskursione, pjesëmarrje në programe ndërkombëtare shkëmbimi e të tjera.

Rezultati 1.4. Zbatohen procedura të financimit të qëndrueshëm të arsimit në Komunën e Prishtinës.

Masa 1.4.1. Përmirësimi i planifikimit buxhetor.

Në bazë të buxhetit komunal, granteve shtetërore dhe donacioneve, përpilohet plani adekuat për zhvillimin e arsimit. Për qasje më sistematike e koherente, në mars të secilit vit realizohet një Rishikim i Përbashkët Vjetor në sektorin e arsimit në Komunën e Prishtinës. Ftohen përfaqësues të bizneseve, autoriteteve arsimore, OJQ, shkolla, donatorë, prindër, etj. Bëhet rishikimi vjetor i zbatimit të planit strategjik dhe planifikimi i aktiviteteve – buxhetit për vitin vijues, për secilin vit të zbatimit të këtij plani strategjik.

Masa 1.4.2. Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik.

Përmes rishikimit të përbashkët vjetor mobilizohen dhe konsolidohen të gjitha fondet e mundshme për financim të arsimit në Komunën e Prishtinës. Këtu përfshihen granti komunal nga buxheti nacional (subvencionet), mjetet vetanake të komunës, donacionet e brendshme e të jashtme, projektet, kontributet e komunitetit, partneritetet publiko private, nismat me bazë në komunitet, e të tjera. Pas kësaj hartohen skenarët e financimit të arsimit në Komunën e Prishtinës.

Masa 1.4.3. Stimulimi i menaxhmentit, mësimdhënësve të dalluar sipas performancës së treguar.

Duke u nisur nga rezultatet e treguara në ngritjen e performancës së shkollës, DKA do të bëjë nxitjen dhe motivimin e menaxhmentit të shkollave e të mësimdhënësve për punë me mjete materiale ose forma të ndryshme të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Masa 1.4.4. Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit.

Sigurohen mjete për realizim të vizitave me karakter studimor që mundësojnë zbatimin e përvojave të marra nga jashtë në vendin tonë. Pastaj zgjidhen drejtuesit, koordinatorët e cilësisë dhe mësimdhënësit për të marrë pjesë në këto vizita. Këto vizita realizohen në vendet e rajonit, me fokus në shkëmbimet me autoritetet, institucionet dhe punëtorët arsimorë të Republikës së Shqipërisë. Vizitat realizohen për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara, por edhe për të mundësuar shkallë më të lartë të integritit të arsimit në gjuhën

shqipe në rajon. Në to marrin pjesë personeli arsimor që ka treguar performancë dhe rezultat të shkëlqyeshëm në punë.

Rezultati 1.5. Është siguruar funksionim efikas në paralelet e ndara dhe në shkollat e vogla rurale.

Masa 1.5.1. Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale.

Fillimisht do të bëhet një vlerësim i gjendjes dhe funksionimit të shkollave të Komunës së Prishtinës nga perspektiva e variablave madhësi e shkollave dhe cilësi e menaxhimit/performancës. Nga vlerësimi do të hartohet një libër i gjelbër me alternativat e mundshme. Këto alternativa do të diskutohen me komunitetin në zonat përkatëse. Pastaj DKA do të vendos për opsionin për zbatim. Pas tjerash ky plan duhet të eliminojë përfundimisht zhvillimin e mësimin në klasë të kombinuar si formë e papranueshme e mësimin për shekullin 21 në Kosovë.

Masa 1.5.2. Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave.

Në vijim hartohet plani me masat për konsolidimin e shkollave, duke e njoftuar komunitetin për vendimet dhe mënyrën e zbatimit. Plani do të përfshijë masat për sigurim të transportit, risistemimin e mësimdhënësve, mënyrën e përdorimit të ndërtesave që mund të mbeten të papërdorura, strategji për integrimin e fëmijëve, adaptimin e fëmijëve që kanë mësuar në klasë të kombinuara me mënyrën e re të të mësuarit e të tjera. Shkollat që mbesin pa nxënës mund të shfrytëzohen nga vendi/fshati/komuniteti, për një qendër kreative, apo shtëpi shëndeti, apo një lloj kampi veror për të gjitha shkollat e komunës.

Rezultati 1.6. Mësimdhënësit zbatojnë me përkushtim shkathtësitë e fituara në programet e zhvillimit profesional.

Masa 1.6.1. Hartohen politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Komuna e Prishtinës - DKA harton dhe aprovon rregulloret për zbatim të politikave të MASHT për zhvillim profesional me bazë në shkollë dhe për zbatim të qasjeve të reja në mësim. Këtu përfshihen edhe rregullore për zbatimin dhe përkrahjen e zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Në masat e përkrahjes përfshihet edhe përkrahja e resurseve njerëzore e sigurimi i përkrahjes materiale për zbatim të programit zhvillimor.

Masa 1.6.2. Hartohet Plani për zhvillimin profesional të personelit mësimdhënës dhe administrativ.

Plani për zhvillimin profesional të mësimdhënësve hartohet duke u bazuar në planet individuale të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe në Katalogun e Trajnimeve të Akredituara nga MASHT-i. Në bazë të nevojave të vlerësuara hartohet lista prioritare e trajnimeve, mësimdhënësit, shkollat, vendet e aftësimit, përkrahja dhe fondet. Një rëndësi e veçantë ju kushtohet aftësimit dhe përgatitjes së kujdestarëve të klasave, sidomos në fushën e këshillimit në karrierë, komunikimit me nxënësit e me kolegët, krijimit të planeve individuale zhvillimore, organizimit të takimeve, e të tjera.

Masa 1.6.3. Zbatohet Plani për zhvillimin profesional.

Caktohen kriteret kryesore për zhvillimin profesional në Komunën e Prishtinës: kualifikimi i trajnerëve dhe organizatave ofruese të programeve, mënyra e organizimit, vendi, kostoja, përkrahja materiale e të tjera. Identifikohen programet dhe organizatat ofruese të zhvillimit profesional. Planifikohet orari i trajnimeve të akredituara nga MASHT, në harmonizim me orarin mësimor të mësimdhënësve. Plani për zhvillim profesional përmban edhe aktivitete të përbashkëta të ZHPM me mësimdhënës të tjerë nga rajoni (Shqipëri, Maqedoni, Mal i zi).

Masa 1.6.4. Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional.

DKA organizon hartimin e një kornize për monitorimin e zhvillimit profesional. Korniza bazohet në planet zhvillimore të shkollës, por edhe në planet individuale të mësimeve për zhvillim profesional. Pas hartimit të rregullores, zbatohet monitorimi, dhe në mënyrë periodike, vlerësimi i programeve për zhvillim profesional të mësimeve në Komunën e Prishtinës. Çdo vlerësim jep edhe rekomandimet për përmirësim të programeve.

Masa 1.6.5. Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM.

DKA Prishtinë, në bashkëpunim me MASHT, krijon dhe përditëson bazën e të dhënave për ZHP të mësimeve. Baza e të dhënave shërben, pos tjerash, për shpërndarje të barabartë të shërbimeve të aftësisë profesionale ndër mësimeve. Përcjellën të gjitha programet e ngjarjet aftësuese të miratuara nga DKA / MASHT, përfshirë ato në formë seminari, me bazë në shkollë, trajnimet online, hulumtimet arsimore e të tjera. Një nga zyrtarët e DKA-së caktohet përgjegjës për bazën e të dhënave dhe krijon dhe përditëson të njëjtën. Zyrtari harton raporte të rregullta tremujore.

6. Zbatimi i kurrikulës së re

Objektivi 2: Kurrikula e re zbatohet në mënyrë të planifikuar dhe cilësore

Korniza e Kurrikulës së Kosovës (2011) e bazuar në kompetenca ka sjellë risi të konsiderueshme në arsimin parauniversitar të Kosovës. Pos përparësive të dukshme krahasuar me kurrikulën e mëparshme të bazuar në përmbajtje (përqendrimi në nxënësin, qasja e integruar dhe zbatimi i gjuhës angleze prej klasës së parë), kurrikula e re ka sjellë edhe sfida të mëdha para mësimdhënësve, prindërve dhe udhëheqjes arsimore në përgjithësi. Këto sfida kanë ardhur pjesërisht si rezultat i mënyrës së zbatimit të saj në vitet e para pas miratimit, si dhe për mungesë informimi e përfshirjeje të duhur të punëtorëve arsimor dhe autoriteteve vendore në procesin e deritanishëm të zbatimit. Deri tani, kurrikula e re është pilotuar në shtatë shkolla të Komunës së Prishtinës me rezultate dhe efekte të përziera në fillim të procesit.

Pilotimi i kurrikulës, por edhe shtrirja e zbatimit të saj nëpër të gjitha shkollat e Kosovës duke filluar nga ky vit shkollor (2017/18) ka ngritur shumë çështje dhe qëndrime, shpesh edhe kundërshtuese, në nivel të shkollave (përfshirë dhe komunitetin).

Rezultatet e pritshme

Për këto arsye, DKA Prishtinë, sikur edhe komunat e tjera në Kosovë, është mobilizuar për një trajtim më serioz të zbatimit të kurrikulave të reja, shprehur para së gjithash në sigurimin e një komunikimi më të mirë në mes të niveleve të autoriteteve arsimore, por edhe në përkrahjen më të madhe të mësimdhënësve të gjendur para një sfide të një natyre të tillë. Një qasje dhe mobilizim i këtillë është pasqyruar në rezultatet e identifikuar të pritshme në vijim:

Rezultatet:

- Realizohet bashkëpunim i mirë institucional mes të gjitha palëve me interes për zbatim të kurrikulës.
- Mësimdhënësit janë të informuar mirë, të përkushtuar dhe të hapur për zbatimin e ndryshimet që sjellë kurrikula e re.
- Është siguruar infrastrukturë, mjete dhe tekste shkollore të harmonizuara me kërkesat e kurrikulës së re.

Për realizimin e këtyre rezultateve, Komuna e Prishtinës parasheh krijimin e trupave koordinuese, koordinatorëve të cilësisë, vendosjen e një procesi të rregullt të raportimit, organizimin e ngjarjeve informative, aftësimin e mësimdhënësve e personelit administrativ, sigurimin e përkrahjes për shkolla e mësimdhënës e të tjera.

Rezultati 2.1. Përmirësohet koordinimi dhe bashkëpunimi institucional për zbatim të kurrikulës.

MASHT-DKA-IPK-Shkollë-OJQ bashkëpunojnë të gjitha për zbatim të kurrikulës. Shkolla raporton në DKA për përparësitë dhe mangësitë e zbatimit të kurrikulës. DKA ngarkon koordinatorët e cilësisë dhe ekspertizë të jashtme për vlerësimin e procesit të zbatimit, duke organizuar kështu një proces monitorimi. Në bazë të rezultateve hartohet një plan intervenues ku ndahen përgjegjësitë e secilit institucion dhe zyrtar për zbatim sa më të mirë të kurrikulave të reja.

Masa 2.1.1. Krijohet një trup komunal për bashkërendimin dhe lehtësimin e zbatimit të kurrikulës.

Në përbërje të këtij ekipi janë hisedarët kryesorë për zbatimin e kurrikulës me mandat për përkrahjen e shkollës dhe mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës. Trupi koordinues emërohet nga Drejtori i DKA-së dhe mban mbledhje të rregullta periodike për shqyrtimin dhe vlerësimin

e procesit të zbatimit të kurrikulës. DKA / Komuna e Prishtinës ndan mjete për funksionimin e trupit koordinues në përkrahjen e masave për lehtësimin e zbatimit të kurrikulës.

Masa 2.1.2. Organizohen punëtori të përbashkëta për tejkalimin e sfidave në zbatimin e kurrikulës së re.

Në këto punëtori identifikohen sfidat, nevojat, kërkesat që dërgojnë në mbështetjen e shkollave për implementim sa më të suksesshëm. Qëllimi kryesor i punëtorive është shqyrtimi i procesit të implementimit të KKK. Në punëtori bëhet raportimi i rregullt nga monitorimi i zbatimit të kurrikulës raportojnë koordinatorët e cilësisë.

Masa 2.1.3. Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave.

Ndahen detyrat, përgjegjësitë, temat, programet, resurset, mjetet për realizimin e planit periodik të veprimit për përkrahje të zbatimit të kurrikulës. Realizohet plani i aftësimit sipas nevojave të identifikuara.

Masa 2.1.4. Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës.

Trupi koordinues organizon hartimin e kornizës së monitorimit. Koordinatorët e cilësisë në nivel komune dhe shkolle zbatojnë planin e monitorimit nën mbikëqyrje të trupit koordinues komunal për zbatimin e KKK.

Masa 2.1.5. Analiza, planifikimi dhe hartimi i kurrikulave të profileve të AAP

Do të realizohen analiza të tregut duke iu referuar praktikave të mira ndërkombëtare dhe do të merren parasysh studimet e realizuara nga organizata të tjera, si dhe do organizohen intervista dhe grupe fokusi me ndërmarrje e organizata afariste në Prishtinë. Diskutimi për programe të reja kryhet në një punëtori për kurrikulat e arsimit profesional me koordinim të Këshillit Industrial të Komunës së Prishtinës. Vendimi i DKA-së për profilet e reja merr parasysh rekomandimet e diskutimit të organizuar nga Këshilli.

Rezultati 2.2. Mësimdhënësit janë të informuar mirë, të përkushtuar dhe të hapur për zbatimin e ndryshimet që sjellë kurrikula e re.

Masa 2.2.1. Organizohen takime dhe punëtori për shkëmbim të përvojave në zbatimin e kurrikulave

Organizohen punëtori të rregullta mujore me trajnues të kualifikuar në secilën shkollë për informim të ndërsjellë dhe për tejkalimin e paqartësive lidhur me implementimin e kurrikulës së re. Përmes takimeve, punëtorive të ndryshme në mes së të gjithë palëve arrihet shkëmbim i informatave dhe praktikave cilësore dhe mundësohet tejkalimi i sfidave.

Masa 2.2.2. Krijim i mekanizmave për motivimin e mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës.

Në këtë masë do të bëhet identifikimi i sfidave por edhe i nevojave për përkrahje të mësimdhënësve, si në kuptimin e teknologjisë arsimore dhe të aftësimit profesional në funksion të zbatimit më të mirë të kurrikulës.

Masa 2.2.3. Aftësimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve për vlerësimet e standardizuara (testet e jashtme, matura, PISA, e tjera)

DKA, në koordinim me MASHT, OJQ e donatorë të ndryshëm, organizon programe aftësimi me mësimdhënës në fushën e vlerësimit të standardizuar të nxënësve. Programet e aftësimit do të jenë praktike dhe konkrete për fushën e vlerësimit të nxënësve. Njëkohësisht, organizohen takime informative me prindër dhe me nxënës për format e këtilla të vlerësimit të nxënësve. DKA do të bashkëpunojë me MASHT dhe me shkollat për hartimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese për këto lloj testesh.

Rezultati 2.3. Është siguruar infrastrukturë, mjete dhe tekste shkollore të harmonizuara me kërkesat e kurrikulës së re.

Masa 2.3.1. Vlerësohet gjendja e përgjithshme e infrastrukturës.

Krijohet ekip për vlerësimin e nevojave për përkrahje materiale në bazë të kërkesave të kurrikulës së re. Analizohen mangësitë dhe planifikohet furnizimi me materiale. Planifikohet krijimi i mjedisit në përputhje me parimet e kurrikulës së re për shembull: kënde të resurseve mësimore nëpër klasa ose në nivel shkolle, këndë për të nxënë bashkëpunues, kushte për zhvillim të mësimin të integruar në laboratorë të përbashkëta të shkencave natyrore, lëndëve të komunikimit, arteve, e të tjera.

Masa 2.3.2. Sigurohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës për zbatim të kurrikulës së re.

Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re. Shqyrtohen resurset me bazë në komunitet duke bashkëpunuar me shkollat, fondacione nga OJQ. Planifikimi i buxhetit aktual bëhet sipas prioriteteve (shih më lartë masën 1.4.1. për Rishikimin e Përbashkët Vjetor të Buxhetit).

7. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore

Objektivi 3: Sigurohet teknologjia e duhur arsimore që mundëson kushte dhe procese optimale mësimore për mësimdhënësit dhe nxënësit për të nxënë efektiv.

Mjetet mësimore dhe teknologjia arsimore mund të jenë një ndër problemet më të mëdha të arsimit kosovar sot. Kjo sepse kur mendojmë në teknologji arsimore në Kosovë mendohet para së gjithash në pajisjet teknologjike si kompjuterë dhe projektorë e shtypës të ndryshëm.

Zhvillimet marramendëse teknologjike të disa viteve të fundit kanë bërë që shkolla ta humbë përparësinë që kishte më parë në komunitet si vendi më i avancuar sa i përket dijeve dhe pajisjeve teknologjike. Ngjashëm me shkollën, edhe mësimdhënësit shpesh ngecin pas nxënësve të vet në përdorimin e teknologjive të reja. Zhvillimet e teknologjisë e kanë bërë të vështirë edhe përcjelljen e tyre nga shkollat – sidomos kur dihet sa të kufizuara janë mjetet në dispozicion për këtë qëllim në Komunat e Kosovës. E gjithë kjo ka bërë që shkollat të ballafaqohen me një mori sfidash e vështirësish në përcjelljen e hapit me trendët teknologjike.

Rezultatet e pritshme

Të kuptuarit e ngushtuar të teknologjisë arsimore e heq theksin nga nevoja për përdorim kreativ të kësaj teknologjie në funksion të përmirësimit të procesit mësimor. Në këtë kontekst, Komuna e Prishtinës është përcaktuar për të parë teknologjinë arsimore si një koncept më gjithëpërfshirës që do të përfshijë pajisjet teknologjike, materialet arsimore dhe përdorimin e tyre, gjithnjë në funksion të rritjes së kreativitetit në organizimin e procesit mësimor. Njëkohësisht, është vendosur që shkollat të furnizohen më shumë se deri tani me teknologjinë e duhur për të mbajtur hapin me zhvillimin dhe dijen në vend. Ky përcaktim është reflektuar në rezultatet e pritura të identifikuara nga pjesëmarrësit:

Rezultatet:

- Është bërë pajisja e shkollave me mjete të TIK-ut;
- Shkollat janë pajisur teknologji arsimore dhe shfrytëzojnë burimet online dhe digjitale;
- Të gjitha shkollat, përfshirë ato profesionale, janë pajisur me punëtori, laboratorë/kabinete dhe me materiale shpenzuese për punë praktike;
- Janë zhvilluar kapacitetet për përdorim dhe mirëmbajtje të teknologjisë arsimore;

- Janë siguruar një numër i konsiderueshëm i donacioneve nga donatorët, bizneset dhe komuniteti dhe është rritur buxheti i dedikuar për teknologji arsimore dhe pajisje të TIK-ut në shkolla.

Rezultati 3.1. Është bërë pajisja e shkollave me mjete të TIK-ut.

Masa 3.1.1. Vlerësohen nevojat dhe bëhet furnizimi i shkollave me mjete të TIK-ut.

Fillimisht është themeluar një ekip për të vlerësuar gjendjen e shkollave sa i përket mjeteve të TIK-ut dhe është hartuar lista e nevojave dhe prioriteteve. Përfundojnë të gjitha procedurat e tenderimit për të përzgjedhur operatorin i cili do të bëjë furnizimin e shkollave me mjete të TIK-ut. Në bazë të prioriteteve të vlerësuara nga ekipi për identifikimin e nevojave, bëhet shpërndarja e mjeteve të TIK-ut në shkolla. Një ekip profesionistësh shkojnë nëpër shkolla dhe ndihmojnë personin përgjegjës për mënyrën e funksionalizimit të pajisjeve të TIK-ut.

Masa 3.1.2. Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla.

Kompania e përzgjedhur nga Komuna e cila i nënshtrohet tenderimit, përkujdeset për rregullimin e pajisjeve të TIK-ut në shkolla në rast se një gjë e tillë është e pamundur të bëhet nga mësimdhënësit e përcaktuar për mirëmbajtjen e pajisjeve në shkolla ose nga Klubet Teknike të Nxënësve.

Rezultati 3.2. Shkollat janë pajisur me teknologji arsimore dhe shfrytëzojnë burimet online dhe dixhitale.

Masa 3.2.1. Krijimi i ekipit për identifikimin e nevojave të shkollave për teknologji arsimore.

Formohet një ekip i cili do të shkojë në të gjitha shkollat për të parë gjendjen aktuale të shkollave sa i përket teknologjisë arsimore ku do të identifikoheshin edhe nevojat e shkollave. Ekipi do të intervistojë mësimdhënësit e menaxhmentin për të parë nevojat e shkollave për implementim efektiv të mësimin. Ky ekip hulumton trendet e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë. Ekipi i formuar pjesë e të cilit janë ekspertë të fushës, hulumton për një kohë teknologjinë arsimore më e përdorur në botë dhe të cilat kanë treguar rezultate në organizimin e mësimin. Në kuadër të kësaj mase mund të organizohen edhe udhëtime studimore në vendet në rajon ose në Evropë. Ekipi mund të kontaktojë edhe institucionet partnere të shkollave tona. Në fund ekipi do të hartojë kriteret për teknologjinë arsimore për përdorim në shkollat e Komunës së Prishtinës.

Masa 3.2.2. Hartohen pakot themelore dhe të specializuara të teknologji arsimore.

Pakot hartohen sipas prioriteteve dhe nivelit arsimor (0, 1, 2, 3), llojit të shkollimit (profesional – i përgjithshëm), drejtimit (shkenca, arte, matematikë), profilit (varësisht nga profili i shkollës profesionale). Sigurohen pakot e teknologjisë arsimore dhe bëhet shpërndarja e tyre në shkolla dhe institucione parashkollore.

Masa 3.2.3. “School Me” dhe platformat online të të nxënit.

DKA organizon një proces për vlerësimin e platformave më të mira softuerike mësimore (online dhe offline). DKA vendos për pilotimin e më shumë se një platforme të tillë për të parë efektin e tyre në mësimdhënie dhe në të nxënë. Në bazë të rezultateve të pilotit, DKA vendosë të shtrijë zbatimin e platformës më të mirë në 10 shkolla. Për zbatimin e saj bëhet informimi, respektivisht, aftësimi paraprak i personelit dhe i nxënësve. Varësisht nga rezultatet e përdorimit të platformave të ndryshme, bëhet edhe shtrirja e përdorimit të tyre nëpër shkollat e tjera në bashkëpunim me partnerët, donatorët, prindërit, MASHT-in e të tjerë.

Masa 3.2.4. Digjitalizimi i ditarëve dhe dokumentacionit pedagogjik.

Në kohën e sotme, digjitalizimi i shërbimeve dhe funksioneve arsimore është bërë pjesë e domosdoshme në të gjitha nivelet e procesit arsimor. Digjitalizimi i ditareve dhe e dokumentacionit pedagogjik ndihmon komunikimin e shkollës me nxënësit dhe me prindërit, por edhe me autoritetet dhe me komunitetin. Avancimi i SMIA-s e bën këtë përpjekje edhe më të realizueshme. Prandaj gjatë këtij procesi të digjitalizimit, është me rëndësi që të realizohen aplikacione kompatible me sistemin e SMIA-së.

Rezultati 3.3. Të gjitha shkollat, përfshirë ato profesionale, janë pajisur me punëtori, laboratore/kabinete e me materiale shpenzuese për punë praktike

Masa 3.3.1. Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë dhe kabinete.

DKA formon ekipin koordinues për përcaktimin e konceptit, qasjes dhe për vlerësimin e nevojave për kabinete dhe laboratorë në shkollat e përgjithshme dhe profesionale të Prishtinës. Organizohet një studim lidhur me trendët përkatëse në vendet me arsim të avancuar dhe përcaktohet koncepti, qasja dhe përparësitë për furnizim të shkollave me punëtori, laboratorë e kabinete. Pas kësaj, hartohen kriteret, standardet, manualët (për përdorim, mirëmbajtje e siguri), dhe udhëzuesit për laboratorë dhe kabinete. Në fund hartohet plani për furnizim të shkollave me punëtori, laboratorë e kabinete. E njëjta procedurë aplikohet edhe për furnizimin me materiale shpenzuese për punë praktike.

Masa 3.3.2. Alokohen mjetet dhe publikohet tenderi për pajisje me punëtori, laboratorë e kabinete.

DKA dhe organet përkatëse komunale alokojnë mjetet e nevojshme në bazë të nevojave të identifikuar. Pas hartimit të planit për prokurim bëhet shpallja e thirrjes për furnizim të shkollave me punëtori, laboratorë e kabinete. Njëkohësisht shpallet thirrje edhe për furnizim me materiale shpenzuese. Furnizimi dhe shpërndarja e mjeteve bëhet në bazë të planit për pajisje të shkollave me punëtori, kabinete / laboratorë dhe me materiale shpenzuese.

Rezultati 3.4. Janë zhvilluar kapacitetet për përdorim dhe mirëmbajtje të teknologjisë arsimore.

Masa 3.4.1. Identifikohen nevojat e mësimdhënësve për trajnime në fushën e teknologjive të reja.

Krijohet ekipi për vlerësimin e mësimdhënësve për të identifikuar nevojat për aftësimin e përdorimit të teknologjisë arsimore dhe pajisjeve të tjera. Pas kësaj hartohet lista me nevojat e mësimdhënësve për aftësim të cilat pastaj barten tek ekipi profesional i formuar për aftësimin e këtyre mësimdhënësve.

Masa 3.4.2. Hartimi i planit të veprimit.

Ekipi i autorizuar harton planin e veprimit për trajnimin e mësimdhënësve në bazë të nevojave të dala pas vlerësimit. Plani i hartuar i veprimit duhet të miratohet nga DKA para fillimit të zbatimit të tij në shkolla.

Masa 3.4.3. Zbatohet aftësimi i mësimdhënësve.

Përcaktohen grupet në bazë të nivelit të njohurive e fushave të interesimit. Për zbatimin e aftësimit aplikohet një qasje sistematike për të siguruar që secili mësimdhënës në komunë / shkollë të përfshihet në së paku një trajnim në bazë të nevojave, ofertës për aftësim dhe mundësive buxhetore. Programi i aftësimit përfshinë edhe konceptin e të kuptuarit e ri të teknologjisë arsimore.

Masa 3.4.4. Klubet për përkrahje teknike.

Në kuadër të Zhvillimit profesional me bazë në shkollë, identifikohen dy mësimdhënës që mund të jenë mësimdhënësit e TIK-ut, të cilët përpos që do të mirëmbajnë pajisjet teknologjike arsimore do të përkujdesen për mësimdhënësit të cilët do të kenë nevojë për ndihmë në

vazhdimësi. Përparësi u jepet proceseve mësimore dhe krijimit të resurseve nga materialet në dispozicion (në funksion të ngritjes së kompetencave). Këta mësimdhënës organizojnë edhe klubet e nxënësve për përkrahje teknike si dhe mësimdhënësit në fjalë mbështeten nga institucionet. Klubet teknike përkujdesen përkujdes për hapjen e ueb faqeve të shkollave dhe në vazhdimësi i mirëmbajnë, kontrollojnë dhe përditësojnë ato me informacione të reja.

Masa 3.4.5. Aftësimi i mësimdhënësve për përdorimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe kabineteve

Furnizuesit e laboratorëve e kabineteve bëjnë aftësimin përkatës të personelit me aspektet teknike e teknologjike të pajisjeve të siguruara, ndërsa DKA së bashku me furnizuesit bëjnë aftësimin profesional për përdorimin e laboratorëve dhe kabineteve. Po ashtu, DKA dhe menaxhmenti i shkollave organizojnë aftësimin e mësimdhënësve për përdorim të sigurtë e të padëmshëm të pajisjeve dhe materialeve shpenzuese dhe informojnë mësimdhënësit dhe nxënësit me materialet përkatëse (manuale, udhëzues) për përdorimin efikas dhe të sigurtë të laboratorëve e të kabineteve.

Rezultati 3.5. Janë siguruar një numër i konsiderueshëm i donacioneve nga donatorët, bizneset dhe komuniteti dhe është rritur buxheti i dedikuar për teknologji arsimore në shkolla.

Masa 3.5.1. Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla.

Organizohet ditë informimi për donatorët dhe organizatat mbështetëse të arsimit në Komunën e Prishtinës. Organizatat donatore informohen për planin strategjik dhe masat që parashihen. Po ashtu, identifikohen organizata dhe biznese të ndryshme të cilat janë të interesuara të kontribuojnë në shkolla duke ofruar fonde për të avancuar zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Masa 3.5.2. Krijimi i mekanizmave brenda shkollave të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me donatorë.

Krijohen pika për bashkëpunim dhe ndërlidhje në nivel të Komunës dhe të shkollës. Mekanizmat në fjalë do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me donatorët, partnerët, komunitetin duke ju ofruar fakte rreth trendëve arsimore në shkollë. Në këtë kontekst, do të organizohen ngjarje të ndryshme me komunitetin, partnerët, prindërit, donatorët, e të tjerë me qëllim informimi dhe komunikimi.

8. Përfshirja në edukimin parashkollor

Objektivi 4: Përmirësimi i përfshirjes dhe i cilësisë së shërbimeve në edukimin parashkollor në Komunën e Prishtinës

Edukimi parashkollor shënon “thembrën e Akilit” të sistemit arsimor kosovar, dhe, njëkohësisht edhe të Komunës së Prishtinës. Përkundër dyfishimit të përfshirjes në në institucionet publike parashkollore dhe pranisë së një numri të konsiderueshëm të institucioneve private, shkalla e përfshirjes (prej më pak se 10%) mbetet me vlera skajshëm të ulëta krahasuar me vendet e rajonit; për krahasim me mesataren e OECD-së apo të Bashkimit Evropian, as që mund të flitet. Sfidat e shumta të këtij niveli të edukimit përfshijnë aspekte financiare, infrastrukturore, por edhe aspekte që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve në këto institucione.

Rezultatet e pritshme

Në këtë nivel të edukimit mbetet inkurajues përfshirja në edukimin parafillor (fëmijët e moshës pesëvjeçare) prej rreth 75%⁹. Një gjë e tillë duket se është arritur, në njërin anë për shkak të krijimit të vetëdijes në komunitet për përfshirjen e fëmijëve në një klasë përgatitore, por edhe fakti se kjo klasë realizohet në institucionet shkollore, në anën tjetër. Të dyja këto momente mbase mund të shfrytëzohen për ngritjen e përfshirjes, por edhe të cilësisë në institucionet parashkollore në Prishtinë. Masat për tejkalim të gjendjes së rëndë në sektor janë pjesë e një qasjeje sistematike që trajton mungesën e mjeteve, infrastrukturës, hapësirës, personelit të kualifikuar e të tjera.

Rezultatet:

- Ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore që mundësojnë dyfishimin e numrit të fëmijëve të përfshirë në edukim parashkollor.
- Janë siguruar fonde të mjaftueshme për përmirësim dhe zgjerim të shërbimeve në EPSH.
- Janë organizuar trajnime të vazhdueshme për zhvillim profesional të edukatorëve dhe të personelit administrativ në IP që kanë bërë që në edukimin parashkollor zbatohen metodologjitë më efektive pedagogjike dhe profesionale.
- Institucionet parashkollore ofrojnë shërbime shëndetësore dhe psiko-pedagogjike funksionale dhe të integruara në edukim parashkollor.
- Institucionet parashkollore zbatojnë në tërësi standardet e organizimit të punës edukative-arsimore në IP.

Rezultati 4.1. Janë ndërtuar kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore për dyfishimin e numrit të fëmijëve në EP.

Masa 4.1.1. Hartohet dhe zbatohet programi i investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë.

Formohet një grup punues për hartimin e programit të masave për përmirësimin e infrastrukturës në EPSH në Prishtinë. Programi do të hartohet në bazë të vlerësimit paraprak të gjendjes në IP. Grupi punues do të përfshijë ekspertë të DKA-së, ekspertë të jashtëm, përfaqësues të OJQ-ve përkatëse, dhe përfaqësues të Asamblesë Komunale. Programi do të vlerësojë gjendjen, do të identifikojë nevojat dhe do të rekomandojë masat për rritjen e kapaciteteve infrastrukturore.

⁹ Burimi: Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe DKA.

Masa 4.1.2. Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve.

Do të zbatohen masat e programit nëpërmjet të ndërtimit të IP-ve të reja, zgjerimit të objekteve ekzistuese dhe renovimit e përmirësimit të infrastrukturës e të kushteve të punës në IP në Prishtinë. Për zbatim të programit do të merren parasysh format e ndryshme të fondeve për financim. Synohet që gjatë periudhës së planifikimit së paku të dyfishohen kapacitetet e EPSH.

Rezultati 4.2. Janë siguruar fonde të mjaftueshme për përmirësim dhe zgjerim të shërbimeve të EPSH.

Masa 4.2.1. Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor.

Do të formohet një grup punues me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm për të studiuar praktikat e mira ndërkombëtare dhe mundësitë për zgjerimin e llojeve të shërbimeve të ofruara në IP në Prishtinë. Grupi do të studiojë literaturën, do të marrë pjesë në vizita studimore, do të konsultojë menaxhmentin e IP-ve ekzistuese, dhe komunitetin për të dhënë rekomandimet e veta (ndër shërbimet shtesë mund të përfshihen: orar i zgjatur me pagesë, shërbime shtesë në fundjavë, shërbime mobile këshilluese, shërbime mobile kujdestarie e të tjera).

Masa 4.2.2. Hartimi i rregullores për mbledhjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti.

Formohet grup punues për hartimin e rregullores duke u bazuar në Ligjin për edukim parashkollor që lejon IP të mbledhin donacione dhe kontribute nga komuniteti. Për shkak të rëndësisë së saj dhe për të evituar keqpërdorimet eventuale, rregullorja pilotohet në disa shkolla para miratimit të saj.

Masa 4.2.3. Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme.

DKA do të bashkëpunojë me organizata dhe institucione të mëdha (në veçanti ato që punësojnë numër më të madh të grave/punëtorëve) për të mundësuar themelimin e çerdheve dhe kopshteve në kuadër të organizatave, bizneseve, kompanive, etj. Përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit, DKA, OJQ-të, donatorët, organizatat private dhe publike, prindërit/personeli kontribuojnë në krijimin e kushteve për organizim të EPSH për fëmijët e personelit brenda organizatës, bizneseve, kompanive.

Rezultati 4.3. Janë organizuar trajnime të vazhdueshme për zhvillim profesional të edukatorëve dhe të personelit administrativ në IP.

Masa 4.3.1. Vlerësimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim profesional të edukatoreve dhe personelit administrativ.

Zyrtarët e DKA në bashkëpunim me drejtorët e IP shqyrtojnë kërkesat dhe nevojat për zhvillim profesional dhe hartohet një program e plan vjetor për zhvillimin e personelit.

Masa 4.3.2. Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor.

DKA merr në shqyrtim listën e trajnimeve të kërkuara dhe vlerëson mundësitë e ofruara nga OJQ-të, donatorët dhe nga MASHT. DKA koordinon zbatimin e trajnimeve në përputhje me nevojat e personelit, bënë monitorimin e programeve të zbatuara dhe vlerëson efektin e tyre.

Masa 4.3.3. Aftësohet personeli për zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor.

Secili institucion parashkollor në Prishtinë përcaktohet dhe merr përsipër zbatimin e qasjeve pedagogjike për edukimin parashkollor si qasje tipike e atij institucioni. DKA Prishtinë, në bashkëpunim me OJQ dhe donatorë (KEC, Save the Children, UNICEF, etj.) përkrahë institucionet për zbatimin e qasjes së përzgjedhur.

Rezultati 4.4. Shërbime shëndetësore, psiko-pedagogjike funksionale në edukimin parashkollor.

Masa 4.4.1. Angazhimi i shërbimeve profesional në IP sipas standardeve.

Shërbimet shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike (pedagogu, psikologu, nutricionisti etj.), do të ofrohen në secilin IP në bazë të numrit të fëmijëve dhe nevojave që paraqiten në IP. Një profesionist kështu mund të shërbejë më shumë se një institucion. Pas angazhimit, këta profesionistë mund të ofrojnë edhe shërbime mobile në komunitet në lagjen ku vepron institucioni.

Masa 4.4.2. Shërbimet hartojnë plane të integruara pune .

Të gjithë anëtarët e shërbimeve shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike do të ofrojnë shërbime sipas kërkesave që vijnë nga IP dhe që plotësojnë kërkesat dhe nevojat e fëmijëve.

Rezultati 4.5. Institucionet parashkollore zbatojnë në tërësi standardet e organizimit të punës edukative-arsimore në IP.

Masa 4.5.1. Krijimi i një ekipi komunal për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH.

Ky ekip (zyrtar të arsimit, zyrtar të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës, etj.) nuk merret vetëm me kontrollim e mbikëqyrje, por edhe si këshillues e përkrahës. Në ekipin komunal përfshihen edhe profesionistë – ekspertë. Ekipi komunal realizon kontrole sistematike të zbatimit të standardeve dhe nxjerr rekomandime për avancimin e zbatimit të standardeve.

Masa 4.5.2. Ekipi komunal harton planin e përmirësimit.

Hartohet plani i përmirësimit që identifikon problemet nga inspektimi i IP dhe rekomandon veprime që duhet të ndërmerren – ndërsa IP-të individuale hartojnë planet e veta të përmirësimit duke u bazuar në planin komunal, gjithnjë me qëllim të avancimit të performancës dhe plotësimin të standardeve.

9. Mjedis i sigurt dhe miqësor në shkollë

Objektivi 5: Të realizohet një shkollë e sigurt, miqësore dhe gjithëpërfshirëse në Komunën e Prishtinës në të cilën secili nxënës gëzon kushte optimale për zhvillim personal

Qasjet më të reja në mësimdhënie dhe të nxënësve i kushtojnë rëndësi parësore një mjedisi miqësor dhe atraktiv për të nxënësve bashkëpunues. Sipas këtyre qasjeve mjedisi mundësues dhe procesi i të nxënësve bëhen po aq të rëndësishme sa edhe suksesi në mësim dhe performanca e nxënësve. Në anën tjetër, sado të rëndësishme që të jenë, me mjedis nuk nënkuptohet vetëm infrastruktura shkollore dhe mjedisi fizik i të nxënësve. Këtu fiton rëndësi të madhe atmosfera miqësore, cilësia e komunikimit mësimdhënës-nxënës, pjesëmarrja e lirë dhe aktive e nxënësve në mësim, bashkëpunimi mes nxënësve, e të tjera. Të gjitha këto janë thelbësore për të nxënësve efektiv dhe të qëndrueshëm.

Mungesa e trajtimit të këtyre aspekteve ka rezultuar me një mjedis jo shumë atraktiv e miqësor. Për ilustrim, injorimi i tejzgatur i dhunës mund të reflektohet dhe të ndikojë dukshëm në performancën jo vetëm të nxënësve individualë të prekur nga dhuna por edhe në atë të nxënësve të tjerë e në punën e mësimdhënësve në plan afatgjatë.

Rezultatet e pritshme

Për realizimin e objektivës strategjike të kësaj fushe, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë është përcaktuar për një sërë rezultatesh të pritshme që përfshijnë adresimin e dhunës, krijimin e hapësirave më miqësore, aftësimin e mësimdhënësve për menaxhim më produktiv të klasës dhe zhvillimin e kapaciteteve të personelit menaxhues.

Rezultatet:

- Në shkollat e Prishtinës dhuna luftohet me sukses dhe në mënyrë sistematike me pjesëmarrje aktive të të gjithë faktorëve të rëndësishëm;
- Shkollat në Prishtinë janë të hapura ndaj familjes, komunitetit dhe trendëve më të reja arsimore dhe shoqërore;
- Të gjitha shkollat në Prishtinë plotësojnë një standard minimal të mjedisit miqësor që mundëson të nxënësve efektiv (e dekoruar, e rregulluar/stolisur, e këndshme);
- Menaxhmenti i shkollës dhe mësimdhënësit janë të ndërgjegjshëm dhe të përkushtuar për të siguruar kushte dhe mjedis optimal për të nxënësve të papenguar të nxënësve.

Për secilin prej rezultateve të pritshme janë paraparë një numër masash në funksion të arritjes së objektivës së përcaktuar:

Rezultati 5.1. Në shkollat e Prishtinës dhuna luftohet me sukses dhe në mënyrë sistematike me pjesëmarrje aktive të të gjithë faktorëve të rëndësishëm.

Masa 5.1.1. Trajnimi i mësimdhënësve për shmangie të ndëshkimit fizik ndaj nxënësve. DKA dhe MASHT në bashkëpunim me donatorë dhe partnerë relevant, do të zhvillojnë programe trajnuese për mësimdhënës dhe menaxhment të shkollave, të specifikuara për të menaxhuar me rastet dhe incidentet në shkollë. Këto trajnime kanë për qëllim aftësimin e mësimdhënësve që të evitojnë ndëshkimin fizik, duke përdorë instrumente pedagogjike të lejuara në trajtimet disiplinore. Po ashtu këto trajnime do të kenë edhe komponentin e trajnimit të trajnerëve mësimdhënës, të cilët do të mbajnë trajnime për kolegët e tyre në shkollat përkatëse. Secili mësimdhënës do të përfitojnë nga së paku një trajnim i tillë dhe nga aktivitetet përcjellëse gjatë periudhës së zbatimit të këtij plani.

Masa 5.1.2. Sanksionimi i dhunës në shkollë

Rregullorja e komunale për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë do të specifikojë rregulla dhe ndëshkime specifike sipas shkallës së veprimit në kundërshtim me kodin e mirësjelljes të mësimitdhënësit. Rregullorja do të përmbajë sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimitdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë. Masat duhet të fillojnë nga vërejtja me gojë, vërejtja me shkrim deri në suspendim dhe përjashtim nga procesi edukativo arsimor.

Rezultati 5.2. Shkollat në Prishtinë janë të hapura ndaj familjes, komunitetit dhe trendëve më të reja arsimore e shoqërore.

Masa 5.2.1. Organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin.

Takimet e prindërve duhet të organizohen në nivel shkolle dhe komune, në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me secilin prind të klasës, në fillim të vitit shkolle. Agjenda e takimeve duhet të përpilohet së bashku me prindër për nevojat dhe çështjet që duhet të diskutohen në takime të rregullta me prindër, duhet të kenë pajtueshmërinë e tyre. Raportet nga takimet e prindërve duhet të evidentohen në procesverbal nga mësimitdhënësi kujdestar. Raporti nga takimet paraprake duhet të diskutohet dhe aprovohet nga prindërit në takimet e radhës.

Masa 5.2.2. Takime të rregullta individuale me prindër.

Takimet individuale me prindër duhet të kenë orarin dhe pikat për diskutim siç janë, gjendja shëndetësore dhe psikofizike e nxënësit, nevojat e veçanta të nxënësit, etj., të specifikuar dhe strukturuar në formular të caktuar. Ky formular i bashkëngjitet dosjes personale të secilit nxënës të klasës dhe nivelit përkatës. Format e sipërpërmendura (masa 5.2.1.) aplikohen edhe në takimet e komunikimit individuale me prindër.

Masa 5.2.3. Takime të rregullta me komunitetin.

Takime të rregullta periodike me përfaqësues të komunitetit, të cilat kanë për qëllim identifikimin e çështjeve dhe problemeve të komunitetit. Gjatë këtyre takimeve shkolla me përfaqësues të komunitetit do të hartojë plane konkrete për të trajtuar këto çështje dhe bashkërisht me shkollën dhe me ndihmën e institucioneve të zgjidhin problemet e përbashkëta. Shkollat do të organizojnë ditë të hapura, ditë të prezantimit të kurrikulave dhe lëndëve, ditë të ekspozitave të punimeve të nxënësve, shënim publik të ditës së shkollës, ditë të hapura ku do të aranzhoheshin vizita të profesionistëve për nxënësit e shkollës, e të tjera.

Masa 5.2.4. Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave.

Komuna do të hartojë një udhëzim për angazhimin e prindërve në aktivitete kurrikulare. Shkolla do t'i angazhojë prindërit në mënyrë aktive në realizimin e aktiviteteve kurrikulare.

Masa 5.2.5. Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare.

DKA do të hartojë një udhëzim për angazhimin e prindërve e komunitetit në aktivitete jashtëkurrikulare. Shkolla do t'i angazhojë prindërit në aktivitete të ndryshme jashtëkurrikulare, përfshirë planifikimin dhe realizimin e tyre. Kështu, ata mund të ndihmojnë në planifikimin dhe realizimin e ekskursioneve, vizitave studimore në institucione, në organizimin e ditëve të hapura dhe ngjarjeve shkollore, në organizimin e klubeve më të ndryshme e të tjera (teknike, artistike, shkencore, e të tjera).

Masa 5.2.6. Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë.

Shkolla organizon takime informimi dhe konsultime të rregullta me prindër në drejtim të krijimit të një mjedisi të sigurt. Këto takime trajtojnë temat që kanë të bëjnë me sigurinë e fëmijëve në shkollë, në mjedisin që e rrethon shkollën dhe në relacionin shkollë-shtëpi. Për kësaj, shqyrtohen aspekte të tjera si qëndrimi i mësimitdhënësve, metodologjia e përdorur,

mundësia e kontributit të prindërve për përmirësimin e cilësisë së mësimin dhe të angazhimit të nxënësve.

Masa 5.2.7. DKA trajton me përparësi nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta dhe të nxënësve të talentuar.

DKA, në bashkëpunim me OJQ e donatorë, përkrahë programe që ndihmojnë të nxënit e nxënësve me nevoja të veçanta dhe nxënësit me talente. Për këtë qëllim DKA ndanë mjete financiare në formë të granteve për projekte në mbështetje të këtyre fëmijëve. Njëkohësisht, punohet në masa që krijojnë mjedis më miqësor për nxënësit me nevoja të veçanta dhe më mundësues për nxënësit me talente.

Masa 5.2.8. Përkrahja më e mirë e punës së ekipit komunal për vlerësim (EKV) të nevojave edukative e arsimore të fëmijëve.

Për të ofruar përkrahje të nevojshme dhe të mjaftueshme për ekipin, fillimisht bëhet një analizë e mundësive të përkrahjes, pastaj analizohen përvojat e komunave të tjera të cilat kanë siguruar përkrahje të ekipeve komunale. Në bazë të kësaj analize, bëhet një përshkrim i formave të përkrahjes, përfshirë sigurimin e pagesave për anëtarët e ekipit, në bazë të punës së bërë, takimeve dhe përgjegjësisë brenda ekipit. Në bazë të kësaj, sigurohet buxheti nga zëri buxhetor mallra dhe shërbime (me kontratë të veçantë).

Rezultati 5.3. Të gjitha shkollat në Prishtinë plotësojnë një standard minimal të mjedisit miqësor që mundëson të nxënë efektiv.

Masa 5.3.1. Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv.

DKA e shkollat në bashkëpunim me komunitetin (përfshirë policinë dhe inspeksionin) angazhohen për trajtimin e infrastrukturës në shkollë dhe përreth shkollës me qëllim të rritjes së sigurisë dhe përshtatshmërisë së infrastrukturës për të nxënë. Pos kësaj diskutohen edhe rreziqet që mund të vijnë nga persona të ndryshëm që mund të jenë të angazhuar në aktivitete lidhur me substanca të palejuara e të tjera. Në këto takime diskutohen edhe raste të kimit kibernetik (ang. cyber-crime) që mund të rrezikojnë mirëqenien e nxënësve.

Masa 5.3.2. Indeksi i sigurisë.

DKA harton rregulloren dhe udhëzuesin për indeksin e sigurisë në shkollë ku përfshihen kriteret, procedurat dhe masat për përmirësim. Qëllimi i këtij indeksi është përcjellja sistematike e të gjitha aspekteve të sigurisë në shkollë, konstatimi i gjendje dhe parashikimi e planifikimi i masave që do të çonin në përmirësimin e vazhdueshme të nivelit të sigurisë e mirëqenies së nxënësve.

Masa 5.3.3. Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim.

DKA gjegjësisht ekipi për parandalim të dhunës në shkolla harton pyetësorë anonim dhe i administron ato së paku dy herë brenda vitit në një numër shkollash të Komunës së Prishtinës me qëllim të identifikimit të rasteve të përdorimit të dhunës në shkolla. Të dhënat e hulumtimit përdoren për analizë, për organizim të konferencave dhe për hartimin e planeve për luftimin e dhunës në shkolla.

Masa 5.3.4. Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese

Në kuadër të masave për sigurimin e hapësirave fizike për mësim, DKA në vazhdimësi do ta bëjë vlerësimin e nevojave për shkolla të reja, anekse, salla të sporteve, si dhe kërkesat për renovim e avancim të mjedisit shkollor. Komuna e Prishtinës, gjatë viteve të mbuluar nga ky Plan Zhvillimor i Arsimit, i ka të planifikuara mjetet në vijim për sigurimin e infrastrukturës nga të hyrat vetanake:

Planifikimi për vite	Vlera e planifikuar
2018	1.480.000,00 €
2019	2.000.000,00 €
2020	2.550.000,00 €
2021	3.000.000,00 €
2022	3.500.000,00 €
Gjithsej	12.530.000,00 €

Në anën tjetër, gjatë vitit 2017, Komuna e Prishtinës ka nënshkruar marrëveshje me Bankën Botërore për ndërtimin e pesë objekteve shkollore në territorin e komunës gjatë periudhës së mbuluar nga ky plan zhvillimor. Mesatarisht vlerësohet se mjetet e siguruar në këtë mënyrë kapin vlerën prej rreth 1.5 milionë Euro në vit.

Me rastin e Rishikimeve të Përbashkëta Vjetore, Komuna e Prishtinës – DKA do të bëjë vlerësimin e nevojave dhe vendosjen e prioriteteve edhe në fushën e infrastrukturës shkollore. Në këtë rast, të gjitha palët e përfshira, përfshirë donatorët dhe MASHT-in do të mund të vlerësojnë nevojat dhe të deklarojnë shkallën e përkrahjes financiare për arsimin në Prishtinë. Kjo do të lejojë planifikim të duhur buxhetor për vitin e ardhshëm. Kështu do të krijohet një cikël i investimeve në infrastrukturën shkollore.

Rezultati 5.4. Menaxhmenti i shkollës dhe mësimit janë të ndërgjegjshëm dhe të përkushtuar për të siguruar kushte dhe mjedis optimal për të nxënë të papenguar të nxënësve.

Masa 5.4.1. DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv.

DKA organizon një ekip me qëllim të hartimit të rregullores për mjedisin mësimor. Në këtë ekip marrin pjesë zyrtar të DKA-së, ekspertë të jashtëm, OJQ, prindër, pjesëtarë të komunitetit e të tjerë. Para miratimit, bëhet zbatimi provues në dy-tri shkolla. Pas vlerësimit të pilotit dhe plotësimeve përkatëse, rregullorja miratohet nga organet komunale.

Masa 5.4.2. Organizohen takime për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimit nëpër shkolla.

Angazhohen inxhinierë, disenjatorë të enterierit, programerë, psikologë, sociologë, dhe ekspertë të fushave të tjera për të këshilluar dhe aftësuar menaxhmentin e shkollave për krijimin e mjediseve atraktive të qëndrimit e të të nxënit në shkolla. Organizohen së paku nga dy punëtorë për të gjithë menaxherët e lartë e të mesëm në shkollat e Prishtinës me qëllim të informimit të ndërsjellë dhe zbatimit sa më të mirë të kriterëve për mjedis miqësor mësimor.

Masa 5.4.3. Organizimi i takimeve me organet e sigurisë.

Në mënyrë permanente gjatë vitit shkollor organizohet takim i organeve të sigurisë PK, FSK, KFOR, së paku një takim i shkollës me njërin prej organeve të sigurisë në vit shkollor.

10. Analiza e rrezikut

Gjatë hartimit të Planit për Zhvillimin e Arsimit në Komunën e Prishtinës, u vlerësuan rreziqet – kryesisht faktorë jashtë kontrollit të DKA-së dhe menaxhmentit të shkollave, që mund të ndikonin negativisht në zbatimin e suksesshëm të Planit. Identifikimi i supozimeve u bë gjatë analizës së gjendjes, ndërkaq vlerësimi i rreziqeve u bë gjatë hartimit të masave e aktiviteteve për realizimin e objektivave të Planit. Rreziqet janë renditur sipas fushave të intervenimit dhe si zakonisht është analizuar probabiliteti i tyre dhe shkalla e mundshme e ndikimit në zbatimin e masave të Planit. Në fund, për shkurtazi janë menduar edhe strategjitë e ndryshme për parandalimin, zvogëlimin e efektit negativ ose për tejkalimin e rrezikut. Në vijim jepen rreziqet kryesore sipas fushave të intervenimit dhe strategjitë për shmangien/tejkalimin e tyre.

Menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Të gjitha palët e përfshira janë të përkushtuar për të siguruar menaxhim dhe shërbime cilësore në arsimin e Komunës së Prishtinës.
- Drejtorët e shkollave janë bartës kryesor të proceseve cilësore dhe të depolitizuara arsimore.
- Udhëheqja komunale dhe MASHT sigurojnë fonde të duhura për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës.
- Komuniteti tregon interesim për përkrahjen e arsimit në Komunën e Prishtinës.

Rreziku nga i cili mund të pamundësohet arritja e Objektivit	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
Moskoordinimi i institucioneve qendrore, lokale dhe institucioneve arsimore	3- E madhe	3- I madh	Mobilizim dhe funksionalizim i bashkëpunimit të institucioneve.
Mungesa e mjeteve financiare-buxhetore	3- E madhe	3- I madh	Ngritja e shkallës së planifikimit për rritjen e efikasitetit të mjeteve financiare.
Të kuptuarit e gabuar të planifikimit dhe të projekteve zhvillimore	3- I madh	2- Mesatar	Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve në hartimin dhe planifikimin e projekteve.
Konteksti pronësor i pazgjidhur	3- I madh	3- I madh	Sigurim i shpejtë i zgjidhjes së kontekstit pronësor.
Politizimi i menaxhmentit të shkollave	2- Mesatar	3 – I madh	Marrja e masave për heqjen e varësisë së drejtorëve të shkollave nga autoritetet arsimore e shtetërore të të gjitha niveleve.

Zbatimi i kurrikulës

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Të gjithë faktorët arsimorë e kuptojnë rëndësinë e përparësitë e kurrikulës së re dhe janë të përkushtuar për zbatimin saj.
- Autoritetet kanë në dispozicion programe cilësore të aftësisë që i dedikohen drejtpërdrejt zbatimit cilësor të kurrikulës së re.
- Të gjithë mësimmëdhënësit pa dallim angazhohen me përkushtim dhe përgjegjshmëri në implementimin e kurrikulës së re.

Rreziku nga i cili mund të pamundësohet arritja e Objektivit	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
Mungesë të bashkëpunimit në mes të palëve të involvuara në zbatimin e KKK dhe KB	2- Mesatare	3- I madh	Mobilizim dhe sensibilizim (MASHT, DKA, IPK dhe Shkolla) nga të gjithë palët në ngritjen e vetëdijes dhe nevojës për bashkëpunim në funksion të zbatimit të KKK dhe KB.
Mungesë e llogaridhënies dhe përgjegjësisë për zbatim të KKK dhe KB	3- E madhe	3- I madh	Sigurimi i përfshirjes, respektimi i afateve kohore, ngritja e kapaciteteve/ mbështetja për raportim dhe transparencë.
Mungesë motivimi dhe përkushtimi i mësimit dhe menaxhmentit të shkollave në zbatim të KKK dhe KB	3- E madhe	3- I madh	Përkrahje profesionale, motivuese për mësimit përmes promovimit të praktikave të mira dhe shkëmbimit të përvojave
Mos zbatim në praktikë i njohurive dhe shkathësisë të marra gjatë programeve të trajnimit	2- Mesatare	3- I madh	Monitorimi dhe mentorimi. Po ashtu, para zbatimit të secilit program do të kërkohet lista e aktiviteteve përcjellëse dhe ekzistimi i mjeteve për zbatim të shkathësisë të reja.
Mungesë e investimit në infrastrukturë, mos përdorimi i drejtë i mjeteve të punës	2- Mesatare	2- Mesatar	Hartimi i udhëzuesve dhe aftësimi i personelit para furnizimit me teknologji të re.

Teknologjia arsimore

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Autoritetet qendrore dhe komunale janë të përkushtuara për sigurimin e teknologjisë së duhur arsimore për shkollat e Prishtinës;
- Mësimitdhënësit janë të hapur për përdorim kreativ të teknologjisë arsimore në mësimitdhënie;
- Mësimitdhënësit kanë në dispozicion pajisjet e duhura;
- Ekziston buxheti i duhur për blerjen e furnizimin e pajisjeve të dhe teknologjisë së duhur.

Rreziku nga i cili mund të pamundësohet arritja e Objektivit	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
Buxheti i pamjaftueshëm i Komunës për mbështetjen e shkollave me teknologji	2- Mesatare	3- I madh	Planifikim paraprak i shkollave për nevojat e tyre në mënyrë që Komuna pastaj të parasheh nevojat e shkollave gjatë ndarjes së buxhetit.
Rezistenca e vazhdueshme e tyre për tu aftësuar për përdorim të teknologjisë	2- Mesatare	3- I madh	Njohja e përdorimit të teknologjisë elementare vendimtar në vlerësimin e performancës së mësimitdhënësve.
Keqpërdorimi i internetit nga ana e nxënësve	3- E madhe	3- I madh	Kufizimi dhe rregullimi i përdorimit të internetit.

Edukimi parashkollor

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Udhëheqja komunale, bizneset, dhe popullata janë të vetëdijshëm për rëndësinë e EPSH për Zhvillimin e fëmijëve dhe për performancën e tyre në shkollimin e mëtejshëm;
- Qeveria dhe udhëheqja komunale sigurojnë fondet e kërkuara për dyfishimin e numrit të fëmijëve në EPSH;
- Bizneset janë të interesuar e të përkushtuar për të ndihmuar personelin e vet në përkujdesje për fëmijët e tyre;

- MASHT ka plane konkrete dhe gatishmëri për të ndihmuar komunën për avancimin e shërbimeve të EPSH në Komunën e Prishtinës.

Rreziku nga i cili mund të pamundësohet arritja e Objektivit	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
Mungesa e interesimit të komunitetit dhe i autoriteteve qendrore për EPSH	2- Mesatare	3- I madh	DKA organizon një proces aktiv të informimit për prioritetet zhvillimore të arsimit në Komunën e Prishtinës.
Mungesa e përkrahjes nga bizneset dhe donatorët	2- Mesatare	2- Mesatare	DKA organizon Rishikimin e Përbashkët Vjetor dhe ngjarje të shumta informimi me palët e interesit.
Mungesa kronike e buxhetit dhe përkrahjes së autoriteteve qendrore	3- E madhe	3- E madhe	DKA organizon tryeza dhe takime të rregullta me autoritetet për ngritjen e vetëdijes dhe mobilizimin e resurseve.

Mjedisi miqësor në shkolla

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- DKA dhe menaxhmenti i shkollave janë të përkushtuara të trajtojnë seriozisht rastet e dhunës nëpër shkolla.
- Ekziston përkushtim nga MASHT, organet komunale dhe menaxhmenti i shkollave për të krijuar një mjedis miqësor dhe atraktiv.

Rreziku nga i cili mund të pamundësohet arritja e objektivit	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
Mos raportimi i rasteve të dhunës nga shkolla	2- Mesatare	3- I madh	Institucionalizimi i obligimit për raportimin e rasteve dhe lidhja e kësaj me performancën e drejtuesve të shkollave.
Bashkëpunimi jo i mirë i komunitetit me shkollën	2- Mesatare	3- I madh	Marrëveshje mirëkuptimi në mes komunitetit dhe drejtuesve të shkollave.
Mosgatishmëria e MASHT për hapjen e vendeve të reja të punës në rastin konkret për psikologë dhe pedagogë	3- E madhe	3- I madh	Bartja e kompetencave tek shkollat për nevojat e stafit pedagogjik për shkollat e tyre.

11. Buxheti

Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Prishtinës 2018-2022, parashihet që për periudhën pesëvjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej **€28,053,445**, prej të cilave **€18,988,445** parashihen të mbulohen nga buxheti komunal i Komunës së Prishtinës, ndërsa **€9,065,000** parashihen të mbulohen nga donatorët e ndryshëm dhe/ose institucionet qendrore të Kosovës. Në vijim është buxheti i detajuar për pesë vite të këtij plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit (i shprehur në Euro).

Fusha	Burimi i financimit	Viti					Total
		2018	2019	2020	2021	2022	
1. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë	Buxheti komunal	245,000	329,700	378,800	372,900	399,900	1,726,300
	Donatorët dhe/ose Institucionet qendrore	0	0	0	0	0	0
	Total	245,000	329,700	378,800	372,900	399,900	1,726,300
2. Zbatimi i kurrikulës së re	Buxheti komunal	11,700	59,000	58,700	60,500	57,500	247,400
	Donatorët dhe/ose Institucionet qendrore	0	0	0	0	0	0
	Total	11,700	59,000	58,700	60,500	57,500	247,400
3. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore	Buxheti komunal	401,500	427,500	427,000	424,500	424,500	2,105,000
	Donatorët dhe/ose Institucionet qendrore	0	0	0	0	0	0
	Total	401,500	427,500	427,000	424,500	424,500	2,105,000
4. Përfshirja në edukimin parashkollor	Buxheti komunal	417,000	415,000	410,500	409,500	409,500	2,061,500
	Donatorët dhe/ose Institucionet qendrore	310,000	300,000	305,000	300,000	300,000	1,515,000
	Total	727,000	715,000	715,500	709,500	709,500	3,576,500
5. Mjedis i sigurt dhe miqësor në shkollë	Buxheti komunal	1,607,800	2,127,300	2,592,300	3,132,300	3,633,300	13,088,000
	Donatorët dhe/ose Institucionet qendrore	1,510,000	1,510,000	1,510,000	1,510,000	1,510,000	7,550,000
	Total	3,117,800	3,632,300	4,102,300	4,642,300	5,143,300	20,638,000
Buxheti për të gjitha fushat	Buxheti komunal	2,438,245	3,358,500	3,867,300	4,399,700	4,924,700	18,988,445
	Donatorët dhe/ose Institucionet qendrore	1,820,000	1,810,000	1,815,000	1,810,000	1,810,000	9,065,000
	Total	4,258,245	5,168,500	5,682,300	6,209,700	6,734,700	28,053,445

Masat e parapara në këtë plan janë të gjitha të karakterit zhvillimor dhe investues, domethënë nuk përfshihen shpenzimet operative (pagat, shpenzimet komunale, shpenzimet për ngrohje e të tjera). Në mjetet e planifikuara për planin e ri, përfshihet pjesërisht vetëm mirëmbajtja e objekteve – në kuadër të investimeve kapitale nga të hyrat vetanake të Komunës së Prishtinës të dedikuara për arsim për vitet e mbuluara nga ky Plan Zhvillimor (në shumën prej 12,530,000 euro). Sikur në çdo plan zhvillimor të arsimit pas luftës, edhe këtu shpenzimet kryesore janë investimet në infrastrukturë. Mirëpo, proporcioni i investimeve infrastrukturë - programe zhvillimore është më i balancuar në këtë plan. Pos sigurimit të kushteve për edukim

parashkollor (rreth 3.5 milionë euro) parashihet edhe investimi i rreth 20 milionë euro në infrastrukturë për sigurimin e një mjedisi miqësor. Megjithatë edhe këtu, investimet do të përdoren jo vetëm për ndërtimin e shkollave të reja por edhe për renovimin, zgjerimin e hapësirave ekzistuese, ndërtimin e sallave të sporteve, krijimin e një mjedisi më të mirë brenda shkollave e të tjera. Për dallim mbase të shumicës së planeve të deritanishme të fushës së arsimit në Kosovë, investime të konsiderueshme tash shkojnë në teknologjinë arsimore (përfshirë mjetet mësimore, punëtoritë dhe pajisjet laboratorike e teknologjike) në masën prej rreth 1.7 milionë euro, dhe për krijimin e një mjedisi më miqësor mësimor për nxënësit e kushteve të punës për mësimdhënësit (rreth 0.65 milion euro). Shpenzimet e tjera parashihen për menaxhim e cilësi (rreth 1.5 milionë euro) dhe për zbatim të kurrikulave të reja (rreth 0.2 milion euro).

Sic shihet më lartë, plani parashihet që në pesë vitet e të ardhshme Komuna e Prishtinës do të duhet të sigurojë rreth katër milionë Euro në vit për të mundur realizimin e tij. Nëse merren para sysh mjetet në dispozicion në DKA për mallra e shërbime prej 2.6 milion euro dhe shpenzimet kapitale për infrastrukturë shkollore prej rreth 2 milionë euro në vit, një objektivë e tillë nuk duket e paarrtshme. Megjithëse këto fonde janë të pamjaftueshme për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës (sidomos kur dihet se rreth një milion euro shpenzohen për shujtën e fëmijëve), ato paraqesin një bazë të mirë për planifikim të shpenzimeve gjatë viteve të zbatimit të kësaj strategjie.

Një burim tjetër i rëndësishëm i fondeve për veprimtarinë arsimore në shkollat e Prishtinës mbeten donatorët dhe autoritetet qendrore. Një pjesë (rreth 20%) e shpenzimeve të këtij plani pritet të mbulohen nga mjetet e MASHT dhe të donatorëve. Shumës së mësipërme nga mjetet në dispozicion të komunës duhet shtuar edhe rreth 1.5 milionë euro në vit që sigurohen nga marrëveshja me Bankën Botërore për të krijuar në pasqyrë më optimiste për shkallën e realizueshmërisë së këtij Plani Zhvillimor.

Me organizimin e një Rishikimi të Përbashkët Vjetor dhe me një bashkëbisedim më aktiv me autoritetet qendrore (MASHT), mund të pritet vënia në dispozicion së paku e një pjese të mjeteve të planifikuara nga këto burime. Kësisoj, për zhvillimin e mësimdhënësve Komuna e Prishtinës mund të negociojë me Divizionin për Aftësim të Mësimdhënësve të MASHT, me qëllim që së paku një pjesë e masave të parapara në këtë fushë nga ky plan të trajtohen nga mjetet e MASHT.

Pjesa e kryesore e aktiviteteve për zhvillim profesional të mësimdhënësve do të vazhdojë të sigurohen nga vija e shërbimeve dhe mallrave (edhe ashtu me mjete tejet të kufizuara). Kjo do të nënkuptoj një cilësi të re të ndërveprimit dhe të komunikimit me partnerët, donatorët, por edhe me autoritetet qendrore.

12. Strategjia e komunikimit

Të gjitha aktivitetet e strategjisë së komunikimit të këtij plani do të bashkërenditen nga Grupi Bërthamë për Planifikim i themeluar në fillim të këtij procesi. Kohë pas kohe, Grupi Bërthamë do të kërkojë ndihmën e partnerëve të ndryshëm qeveritarë dhe joqeveritarë - sidomos në kohën e shqyrtimit të zbatimit dhe rishikimit të planit. Pos kësaj, një zyrtar i DKA-së do të angazhohet drejtpërsëdrejti për monitorimin e zbatimit dhe informimin e autoriteteve, partnerëve e të opinionit për procesin e zbatimit të planit. Grupi Bërthamë do të bëjë mbledhjen e rregullt të informatave dhe raportimin vjetor në Asamblenë Komunale lidhur cilësinë e zbatimit të Planit.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Prishtinës ka zhvilluar një proces me pjesëmarrje për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Prishtinës. Pas hartimit të Planit, DKA do ta publikojë planin në uebfaqen e Komunës për informim dhe dhënie të informatave kthyesë nga komuniteti, organizatat joqeveritare dhe punëtorët arsimorë në Prishtinë. Pas diskutimit publik dhe përfshirjes së komenteve eventuale, DKA do ta dorëzojë dokumentin në procedurë të diskutimit dhe të miratimit në Asamblenë Komunale në Prishtinë.

Pas miratimit në Kuvendin Komunal, DKA do të hartojë materialet për informim të palëve të interesit në fushën e arsimit, përfshirë prindërit, OJQ-të dhe bizneset. Për këtë qëllim do të hartohen fletëpalosje dhe broshura informuese, ndërsa në uebfaqe do të jetë vazhdimisht i publikuar plani. Materialet në uebfaqe do të publikohen në gjuhë shqipe, angleze dhe komunitete në mënyrë që të mbërrijë sa më shumë përfitues dhe palë të interesuara. Pos kësaj do të organizohen edhe takime informimi nëpër shkolla për të mobilizuar mësuesin dhe menaxhmentin e shkollave për zbatimin e masave të planifikuara në plan. Pastaj, do të organizohet një ngjarje informative me organizatat qeveritare dhe një takim me bizneset, përkatësisht. Këtu, pos informimit të ndërsjellë do të bëhet edhe marrja e përgjegjësisë e ndarja e roleve për zbatimin e planit brenda mundësive dhe interesimit të palëve të përfshira.

Secilin vit, në muajit korrik do të bëhet shqyrtimi i zbatimit të masave të planit dhe hartimi i planit vjetor të veprimit. Në këtë punëtori të rishikimit e të planifikimit do të përfshihen të gjitha palët e interesit në sektorin e arsimit e të edukimit në Prishtinë. Këto punëtori shqyrtuese do të shërbejnë edhe për të rishikuar e shtuar mobilizimin e partnerëve për zbatimin sa më të mirë të tij. Në veçanti, gjatë procesit të shqyrtimit të zbatimit, do t'i kushtohet rëndësi masave që kanë të bëjnë me grupet e pafavorizuara (nxënësit me nevojat të veçanta arsimore, komunitetet pakicë, vajzat e të tjera).

Në vitin 2020 do të bëhet rishikimi i ndërmjetëm i zbatimit të planit. Me këtë rast do të organizohet një punëtori me përfshirje më të gjerë, duke përfshirë donatorët, partnerët, komunitetin, autoritetet arsimore qendrore dhe ato nga komunat fqinje e të tjera. Ky proces do të nënkuptojë një shqyrtim të zbatimit dhe rishikim të masave të parapara në planin origjinal. Kjo do të bëhet për t'i përshtatur masat me kontekstin e ndryshuar të sektorit arsimor në Prishtinë e më gjerë. Kjo ngjarje do të shërbejë edhe për mobilizimin e mjeteve shtesë për financimin e zbatimit të planit por edhe për kapitalizimin nga mundësi të tjera për zbatim të Planit që mund të dalin si rezultat i avancimit të procesit të integriteteve evropiane dhe rritjes së forcës ekonomike të Komunës ose të buxhetit të Kosovës.

Pos këtyre formave të komunikimit e informimit, do të shfrytëzohen edhe mjetet e informimit (elektronike dhe të shtypura) me qëllim të informimit sa më të mirë të opinionit për procesin zbatimit, përfshirë sfidat dhe sukseset, e këtij plani.

Shtojca 1: Korniza për vlerësimin e performancës

Menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë				
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku 2019	Caku 2022	Mjetet e verifikimit
Numri i zyrtareve në DKA	18		24	Lista e pagave të punonjësve të DKA-së
Numri i koordinatorëve të cilësisë në Komunën e Prishtinës	2	53	53	Lista e DKA-së dhe MASHT-it
Buxheti Komunal për Arsim	25 milionë		28 mil.	Pasqyra/gjendja buxhetore
Numri i shkollave në zona të thella rurale	21		16	Lista e shkollave në DKA
Numri i trajnimeve për aftësimin të personelit	0.9		2.3	Lista e certifikatave e mësimdhënësve
Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve		Shkolla		Dosjet dhe raportet e VPM
Numri i psikologëve dhe pedagogëve	14+2 pedagog		35	Lista e DKA
Numri i programeve të akredituara nga autoriteti kombëtarë i kualifikimeve për SHP			Të gjitha	Lista e programeve të akredituara
Numri i nxënësve për paralele për SHP	32	24		Lista e nxënësve për paralele
Numri i marrëveshjeve me biznese				Lista e marrëveshjeve të bizneseve, Qendra e orientimit në karrierë

Zbatimi i kurrikulës				
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku 2022	Mjetet e verifikimit	
Numri i takimeve informative për kurrikulën e re të organizuara në nivel të Komunës së Prishtinës	0	Së paku 15	Procesverbalet nga takimet të dorëzuara në DKA	
Numri i mësimdhënësve të aftësuar në programe që i dedikohen zbatimit të kurrikulës së re	1256	Të gjithë	Numri i mësimdhënësve të certifikuar	
Raportet e rregullta të koordinatorëve të cilësisë përkitazi me zbatimin e kurrikulës së re	0	Nga tri raporte për secilën shkollë në vit	Raportet e dorëzuara në DKA	
Numri i trajnimeve për kurrikulën e re të organizuara në nivel të Komunës së Prishtinës	5 programe	10 programe (përfshirë metodologjitë e fushave)	Programet e akredituara nga MASHT	
Numri i trajnerëve të angazhuar për mbajtjen e trajnimeve	40	80	Numri i trajnerëve të certifikuar	
Përqindja e rritjes së investimeve në materiale mësimore që janë në funksion të zbatimit të kurrikulës së re				

Teknologjia arsimore				
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku 2022	Mjetet e verifikimit	
Numri i pakove mësimore për shkollë				
Numri i pajisjeve të TIK-ut për shkollë/komunë	22.7	40	Statistikat e DKA-së	
Numri i pajisjeve të TIK-ut për kokë nxënësi në Komunën e Prishtinës	0.028	0.05	DKA	
Numri i laboratorëve	128	150	DKA	
Numri i kabineteve	142	427	DKA	
Numri i aplikacioneve softuerike në përdorim aktiv	6	30	DKA	
Numri i pajisjeve digjitale për shkolla	25	60	DKA	

Numri i klubeve të teknikëve për shkolla			
Numri i licencave të nxënësve për përdorim të aplikacioneve digjitale			
Numri i mësimdhënësve të certifikuar për përdorim të aplikacioneve			
Shuma e donacioneve për pajisje teknologjike për shkolla			
Numri i raporteve vjetore të shkollave për përdorimin e aplikacioneve dhe pajisjeve			
Numri i uebfaqeve elektronike të shkollave			
Numri i shkollave me ditarë digjital	3	Të gjitha	

Edukimi parashkollor			
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku 2022	Mjetet e verifikimit
Numri i fëmijëve në IPSH në Komunën e Prishtinës	1575		
Shkalla e përfshirjes (përqindja e fëmijëve të përfshirë në EPSH krahasuar me popullacionin)	9.40%		
Numri i IP-ve publike	8		
Numri i IP-ve jopublike	1		
Numri i IP-ve me bazë në komunitet	6		
Numri i profesionistëve që ofrojnë shërbime profesionale në EPSH në Prishtinë	1		
Përqindja e IPSH që ofrojnë shërbime profesionale			
Përqindja e IPSH-ve që ofrojnë të gjitha shërbimet profesionale			
Përqindja e fondeve/donacioneve dhe ngritja e kontributeve të mbledhura nga prindërit dhe komuniteti në nivel të IP-ve			
Numri i memorandumeve të nënshkruara			
Numri i trajnimeve, programeve të organizuara për EPSH			
Rregullore e hartuar për mbledhjen e fondeve/donacioneve			

Mjedisi miqësor			
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku 2022	Mjetet e verifikimit
Numri i incidenteve – ushtrim i dhunës fizike ndaj nxënësve nga mësimdhënësit	~50	0	
Numri i incidenteve – ushtrim i dhunës fizike i nxënësve ndaj nxënësve	~100	~50	
Numri i incidenteve – ushtrim i dhunës fizike ndaj nxënësve nga persona jashtë shkollës	~50	~20	
Numri i lëndimeve të nxënësve rrugës për në shkollë, gjatë kohës së mësimimit dhe rrugës për në kthim;	-		
Numri i takimeve me prindërit në shkollat e Komunës së Prishtinës	2 ne vit	4 ne vit	
Numri i kthinave dhe këndeve për mësim atraktiv	59 kënde leximi	100 kënde leximi	
Numri i incidenteve që lidhen me shpërndarjen dhe përdorimin e substancat narkotike	-		
Numri i shkollave me mësim tërë ditor	6		
Numri i trajnimeve për mjedis miqësor	-	2	

Numri i pajisjeve të kamerave të sigurisë në IEAA	25	70	
Numri i psikologëve dhe pedagogëve nëpër shkolla	14+2	35 psikolog	Lista e DKA
Numri i takimeve dhe seancave të psikologëve me nxënësit			
Përkrahja e iniciativave nga mësimdhënësit, nxënësit si dhe komuniteti që kanë të bëjnë në ngritje të cilësisë (grupeve punuese për lëndë të ndryshme)	Aktivitet profesionalë çdo muaj raportojnë në shkollë për punën e tyre dhe çdo 3 muaj në DKA, si dhe mekanizmat të tjerë (koordinatorët e cilësisë, këshillat e arsimtarëve).		

Shtojca 2: Plani i zbatimit dhe buxheti

Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë

Objektivi 1: Zhvillohen kapacitetet njerëzore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshëm të cilësisë në arsimin e Komunës Prishtinë

Rezultati 1.1: Ekziston personel i mjaftueshëm dhe i kualifikuar në nivel të DKA-së dhe të IEAA-ve.											
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.1.1: - Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA Rishikimi e hartimi i kriterëve për punësim	2018-2020	DKA	Shkolla e IP	Buxheti komunal	Vlerësimi: 10 dite Aftësimi 16 dite DKA: 8 Dite 12 zyrtar nga 3 dite ne vit Rishikimi i kriterëve të punësimit: 1500 Eur	3000	19500	38700	45000	72000	178200
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						3000	19500	38700	45000	72000	178200
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.1.2: - Transferimi (migracioni) i brendshëm i personelit dhe i mësimdhënësve nga një shkollë në një shkollë tjetër dhe nga një vend pune në një tjetër në bazë të nevojave dhe mundësive		DKA		Buxheti komunal	Pa kosto	0	0	0	0	0	0
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	0	0	0	0	0

Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.1.3: Sistemimi i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare				Buxheti komunal	Pa kosto	0	0	0	0	0	0
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	0	0	0	0	0
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
1.1.4. Rishikimi funksional i DKA	2018-2019	Komuna e Prishtinës	OJQ / Donatorë	Buxheti Komunal Donator	3500 Euro	2000	1500	0	0	0	3500
Totali i buxhetit për masë (në euro):						2000	1500	0	0	0	3500

Rezultati 1.2: Janë vendosur dhe zbatohen mekanizmat që sigurojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien në procesin edukativo – arsimor në të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Prishtinës											
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.2.1: - Krijimi i ekipit profesional në nivel të DKA për monitorimin e përkrahjen e vlerësimit të performancës së shkollës				Buxheti komunal	Aftësimi (3 ditor) komunikimi (MSH – 400 vit) Ekspertiza e jashtme (10 dite – vit 1500 E)	0	2500	1900	1900	1900	8200
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0

Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	2500	1900	1900	1900	8200
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.2.2: Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës				Buxheti komunal	Dy dite aftësim për 360 anëtarë	0	7200	7200	0	0	14400
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	7200	7200	0	0	14400
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.2.3: Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm	2020-2022	DKA	Shkollat	Buxheti komunal	Një trajnim sipas nevojave për mësimdhënës 2500 X 20 X 2 dite	0	0	35000	35000	35000	105000
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	0	35000	35000	35000	105000

Rezultati 1.3: Ekzistojnë mekanizmat profesionale për sigurimin e cilësisë

Masa					Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)
------	--	--	--	--	---------------------	---

	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit		2018	2019	2020	2021	2022	Tota l
Masa 1.3.1: - Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë				Buxheti komunal	Shpenzimet për takime	3000	5000	5000	5000	5000	23000
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						3000	5000	5000	5000	5000	23000
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Tota l
Masa 1.3.2: Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle				Buxheti komunal Nga PM	40 norma + 1 KC DKA	180000	180000	180000	180000	180000	900000
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						180000	180000	180000	180000	180000	900000
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Tota l
Masa 1.3.3: Mbikqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet)	2018-2022	KC – DKA KC – shkollë	DKA	Buxheti komunal	PA kosto	0	0	0	0	0	0
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0

Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	0	0	0	0	0
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.3.4: Fuqizimi i aktiveve profesionale	2018-2019	DKA	MASHT	Buxheti komunal	4 dite aftësim për aktivet	20000	10000	10000	5000	5000	50000
				Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Masa 1.3.5. Themelimi i Këshillit Industrial të Komunës së Prishtinës	2018	DKA	Ndërmarrjet Komuna e Prishtinës	DKA	N/A	0	0	0	0	0	0
Masa 1.3.6. Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike	2018-2022	Shkollat	DKA KIAP	DKA	NA	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						20000	10000	10000	5000	5000	50000

Rezultati 1.4: Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e funksionit të DKA-së											
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.4.1: Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit)				Buxheti komunal	Rishikimi i përbashkët i buxhetit	3000	3000	3000	3000	3000	15000
				Donatorët Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						3000	3000	3000	3000	3000	15000
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total

Masa 1.4.2: - Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik	2018-2022	DKA ZF	DF	Buxheti komunal	Pa kosto	0	0	0	0	0	0
				Donatorët Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	0	0	0	0	0
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.4.3: - Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkolle), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës.	2018-2022	DKA	MASHT	Buxheti komunal	Një aktivitet në vit (aftësime dhe udhëtime studimore) 6 grupe X 1500	9000	9000	9000	9000	9000	45000
				Donatorët Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						9000	9000	9000	9000	9000	45000
Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.4.4: -Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara.				Buxheti komunal	Shih me larte 1.4.3.	0	0	0	0	0	0
				Donatorët Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						0	0	0	0	0	0

Rezultati 1.5: Janë realizuar zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme që sigurojnë konkurrencë të dijes, llogaridhënie dhe mësim cilësor në paralelet e ndara dhe në shkollat e vogla rurale

Masa	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Institucioni/ Organizata mbështetëse	Burimi i financimit	Përshkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve dhe totali (në euro)					
						2018	2019	2020	2021	2022	Total
Masa 1.5.1: - Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale	2018	DKA	Shkolla	Buxheti komunal	Ekip i përzier (DKA – ekspertize jashtme)	1500	0	0	0	0	1500
				Donatorët Institucionet Qendrore	N/A	0	0	0	0	0	0
Totali i buxhetit për masë (në euro):						1500	0	0	0	0	1500
